



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 90 Akti

Nr. 100 Vendimi
Tiranë më, 14.01.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Firdes Shuli	Anëtare
Roland Ilia	Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot, më datë 09.01.2019, ora 10:00 dhe datë 14.01.2019, ora 12:00, pranë Pallatit të Koncerteve, salla B, kati 0 (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKT I RIVLERËSIMIT : **Z. Alfred Gjoni**, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin dhe njëkohësisht kryetar i kësaj gjykate.

OBJEKTI : **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE : **Nenet 179/b, A, Ç, D, E, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligj nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Gjoni, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Gjoni, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Gjoni, ushtron detyrën e gjyqtarit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Laç, duke qenë njëkohësisht edhe kryetar i kësaj gjykate. Në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është nënshtuar rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni), ka hedhur shortin, më datën 15.01.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Gjoni, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 1, i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Relator i çështjes, u zgjodh me short, komisioner Roland Ilia.

3 Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë (në vijim “IKLD”), ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me shkresën nr *** prot., datë 07.05.2018

4. Me vendimin nr.1, datë 24.01.2018, trupi gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Alfred Gjoni në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Etleda Çiftja. Të gjithë anëtarët kanë deklaruar mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Me vendimin nr. 2, datë 27.11.2018, trupi gjykues, vendosi:

- Të përfundojë hetimin paraprak në lidhje me vlerësimin e pasurisë dhe të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Gjoni.

- T’i njoftojë subjektit të rivlerësimit se provat e grumbulluara për këto dy kritere, kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, dhe duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit kryesisht, duke i vënë në dispozicion rezultatet paraprake të hetimit, në bazë të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, duke i interpretuar në lidhje me nenin D dhe E të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 52.

-Të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurës Administrative.

-Të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën për t'u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitareve, si dhe afatin ditor brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Me vendimin nr. 3, datë 17.12.2018, trupi gjykues, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Gjoni, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 19.12.2018, ora 13:00, pranë Pallatit të Koncerteve (Ish Pallati Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë. Në të njëjtën datë që u dërgua ftesa për seancën dëgjimore duke kërkuar kohë për të dorëzuar dy akte ekspertimi.

7. Me vendim nr. 4, datë 18.12.2018, trupi gjykues pranoi kërkesën e subjektit duke vendosur shtyrjen e seancës për në datë 09.01.2019.

8. Më datë 09.01.2019, ora 10:00, u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Gjoni

9. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit "Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave", trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Gjoni, bazuar në dy komponentë, atë të vlerësimit të pasurisë dhe aftësive profesionale duke mos vendosur mbi kriterin e kontrollit të figurës.

10. Ky vendim mbi përfundimin e procesit të rivlerësimit për z. Alfred Gjoni, merret vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë e atë profesional dhe kjo nuk përbën gjë të gjykuar (*res judicata*) për kriterin e kontrollit të figurës.

II. SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë elektronikisht më datë 18.12.2018.

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 09.01.2019, ora 10.00 në adresën: Pallati i Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (underground), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier De Mongeot

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht dhe deklaroi në seancë që do të përfaqësohej nga avokat z. Ardian Visha. Ai parashitroi shpjegimet e tij në seancë, si dhe i depozitoi ato me shkrim pranë Komisionit.

Në përfundim, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Z. Alfred Gjoni ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit ndaj tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar por e njëjta gjë nuk mund të thuhet për kthimin e përgjigjeve pasi ka dhënë para Komisionit përgjigje të pavërteta dhe kontradiktore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kërkesë për thirrjen e dëshmitarëve me qëllim që të provonte faktet dhe rrethanat e çështjes.

Në lidhje me kërkesën e subjektit të rivlerësimit, Komisioni refuzoi atë për shkak se fakti që u kërkua të provohej me dëshmitarë nga ana e subjektit të rivlerësimit, ishte provuar gjatë hetimit sipas përcaktimeve të nenit 49, pika 6, gërma b, e ligjit nr. 84/2016.

Më tej, dhe nëse i referohemi Kodit të Procedurës Civile, në rastin e një prove të plotë shkresore për të provuar faktin, marrja e një prove me dëshmitarë nuk lejohet, e thënë kjo sipas parashikimeve të nenit 232 të Kodit të Procedurës Civile, i cili specifikon se: *“Nuk lejohet prova me dëshmitarë kundër ose tej përmbajtjes së një akti zyrtar ose privat që përbën provë të plotë”*

A. VLERËSIMI I PASURISË

1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja.

Në përputhje me nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, ka dërguar raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit, z. Alfred Gjoni, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të pasurisë nga ky institucion, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni.

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”;
- b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja;
- c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik;
- e) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit;

Në Deklaratën e Pasurisë “Vetting”, të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 24.01.2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi këto pasuri (të paluajtshme dhe të luajtshme):

- ❖ **Apartament** banimi, me sipërfaqe 60 m², ndodhur në, Rr. “****”, blerë në shumën 1,900,000 lekë, sipas kontratës së shitjes me nr. ***, datë 06.06.2001.

Burimi i Krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

Kursimet nga paga ndër vite si dhe kontribut që i kanë dhënë familjarët e tij, babai dhe vëllai. Këta të fundit i kanë siguruar shumat e parave nga shitja e pronave në qytetin e Laçit, dyqan i shitur në periudhën 1997-1998, tokë e përfitur nga ligji nr. 7501, “Për tokën”, me sipërfaqe 10.000 m², e shitur në vitin 2000 dhe banesë e shitur nga privatizimi në qytetin e Laçit.

Hetimi i kryer nga Komisioni¹

Konstatimi i ILDKPKI-së: *Deklarimi i rremë dhe mungesë burimesh të ligjshme financiare për vlerën 1,900,000 lekë, në vitin 2001, pasi nga dokumentacioni rezultoi që kontrata e shitjes*

➤ ¹ **Shkresë nr. *** prot., datë 01.02.2018, drejtuar ZVRPP-ve**
 Shkresë nr. *** prot., datë 21.02.2018, kthim përgjigje ZVRPP Tiranë.
 ZVRPP Tiranë me shkresë nr. *** prot., datë 21.02.2018, na dërgo të njëjtat të dhëna.
 Shkresë nr. *** prot., datë 07.02.2018, kthim përgjigje, ZVRPP Kurbin.
 Shkresë nr. *** prot., datë 14.02.2018, kthim përgjigje, ZVRPP Bulqizë.

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 21.02.2018, drejtuar noterit public, z. V.LI.**
 Shkresë nr. *** rep., datë 24.02.2018, kthim përgjigje noteri public, z. V.LI.

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 1.2.2018, drejtuar OSHEE-së.**
 Shkresë nr. *** prot., datë 15.02.2018, kthim përgjigje, OSHEE.

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 01.02.2018, drejtuar UKT-së.**
 Shkresë nr. *** prot., datë 14.02.2018 kthim përgjigje UKT

➤ **Shkresë nr. *** prot., datë 04.06.2018 drejtuar Noterit Publik V.LI.**
 Me shkresë nr. *** datë 18.06.2018 noteri publik Z. V.LI. na informon se kontrata Nr. *** rep dhe nr. *** kol datë 02.02.2002 nuk rezultoi në regjistrin e veprimeve noteriale të noterit N.K.
 Me shkresë nr. *** datë 27.06.2018 noteri publik Z. V.LI. na informon se kontrata Nr. *** rep dhe nr. *** kol datë 02.02.2002 gabimisht nuk është regjistruar por na vë në dispozicion kopje të saj të marrë nga ZVRPP Kurbin.

së aseteve në pronësi të babait, të deklaruar si burim, rezultojnë të jenë kryer pas datës 06.06.2001. Kjo është arsyeja që subjekti nuk ka paraqitur edhe dokumentacion justifikues bashkëlidhur deklaratës “Vetting”.

Arsyetim ligjor

Apartamenti i banimit nga ana e subjektit të rivlerësimit është blerë me kontratë shitje nr. ***, datë **06.06.2001**, për shumën 1,900,000 lekë.

1. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” deklaroi si burim të ardhurash për blerjen e apartamentit kursime nga paga dhe kontributi që i kanë dhënë familjarët e tij, babai dhe vëllai duke deklaruar si burim të ardhurash shitjen e pronave në Laç (dyqan i shitur në vitin 1997 - 1998, tokë e përfituar nga Ligji nr. 7501, “Për tokën”, me sipërfaqe 10.000 m² e shitur në vitin 2000 dhe banesë e shitur nga privatizimi në Laç).

a. Pasuritë e cituara më lart janë shitur me kontratat e mëposhtme:

- Kontratë nr. ***, datë **06.02.1997**, nga ku rezultoi se znj. A. dhe z. N.Gj. kanë shitur një lokal me sipërfaqe 21.8 m², në shumën prej **600,000 lekësh**.
 - Kontratë shitblerje toke, nr. ***, datë **02.02.2002**, nga ku rezultoi se, z. N.Gj., ka shitur 10.517 m² tokë arë. Çmimi i shitjes është në vlerën **500,000 lekë**.
 - Kontratë nr. ***, datë **22.06.2001**, nga ku rezultoi se është shitur apartamenti me sipërfaqe 63.7 m², me çmimin e shitjes në vlerën prej **500,000 lekësh**.
- ✓ Nga këto kontrata vërtetohet se vetëm shitja e lokalit me sipërfaqe 21.8 m², në shumën **600,000 lekë** është shitur (rreth 4 vite) përpara se subjekti i rivlerësimit të blente apartamentin, ndërsa dy pasuritë e tjera janë shitur më vonë duke mos përberë burim të ardhurash për blerjen e apartamentit.

Në lidhje me këtë konstatim, subjektit të rivlerësimit, iu kërkua informacion shtesë. Në përgjigjen e tij ai sqaron se: **“Burimi i të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti në vitin 2001 kanë qenë kursimet e tij nga paga e viteve 1995 - 2001 si ndihmës gjyqtar dhe gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, në shumën 1,400,000 lekë dhe shumën 500,000 lekë, i janë dhuruar nga prindërit e tij dhe nga vëllai. Këta të fundit, kanë zotëruar e më pas shitur një dyqan/ëmbëltore në qendër të qytetit të Laçit, si dhe një sipërfaqe toke prej 10.000 m², krahas banesës 2+1, e shitur edhe kjo pas privatizimit në vitin 1991. Paratë e dhuruara kanë qenë cash, e për shkak të vlerës së ulët e raportit familjar, nuk janë shoqëruar me akt noterial apo dokumentim dorëzues të çfarë do lloji. Për sa i përket sqarimit mbi shumat konkrete të shitjes së pasurive të mësipërme të disponuar nga prindërit dhe vëllai i tij, kontratat e shitjeve përkatëse kanë qenë të dorëzuara në kopje autentike pranë ILDKP-së, dhe në dijeni të tij (pasi nuk ka mundur të siguroj kopje të tjera të kontratave), vlerat kanë qenë si më poshtë:**

- Dyqani i shitur në vitin 1997, në vlerën 1,000,000 lekë.

- Toka me sipërfaqe 10.000 m² është shitur në vlerën 1,000,000 lekë.
- Banesa 2+1 është shitur në vlerën 1,500,000 lekë.

Deklarimi i subjektit në lidhje me çmimin e shitjeve të pasurive të paluajtshme të mësipërme nuk përputhet me çmimin në kontratat e shitjes së këtyre pasurive të evidentuara më lart.

Mbështetur në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit rezulton se ai ka marrë nga babai dhe vëllai i tij si dhuratë për blerjen e këtij apartamenti vetëm shumën 500,000 lekë ndërsa pjesa tjetër është mbuluar nga të ardhurat e tij.

Në lidhje me këtë dhurim i është kërkuar subjektit të rivlerësimit që në zbatim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016 të na vinte në dispozicion dokumentacion provues për të provuar dhurimin e kësaj shume nga ana e familjarëve të tij si dhe dokumentacion ligjor provues në lidhje me burimin e ligjshëm të ardhurave të tyre për krijimin e pasurive që kanë në pronësi.

Subjekti i rivlerësimit nuk është paraqiti dokumentacion ligjor justifikues për të konfirmuar dhënien e kësaj shume apo për të provuar burimin e ligjshëm të ardhurave për dhënien e kësaj shume nga ana e familjarëve të tij.

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion ligjor provues marrjen e shumës 500,000 lekë nga familjarët e tij si dhe burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave.

- ✓ Bazuar në dokumentacionin e administruar nga ZVRPP-ja Tiranë, rezulton se z. N.Gj. në po të njëjtin pallat dhe në po të njëjtin kat ka blerë me kontratë shitje nr. ***, datë 03.11.200, për shumën 1,500,000 lekë, një apartament me sipërfaqe 65 m² nga znj. L.Gj.

Subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion shtesë në lidhje me burimi e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti nga ana e babait të tij. Në përgjigjen e tij ai sqaron se të ardhurat janë përfituar nga shitja e apartamentit të privatizuar në qytetin e Laçit, toka me sipërfaqe 10.000 m² dhe dyqani, njëkohësisht nga kursimet e punës së tij e të gjithë familjes në dyqan e tokë bujqësore për periudhën 1992 -1997.

Nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit rezulton si i njëjti burim të ardhurash që është deklaruar për blerjen e apartamentit të tij është përdorur dhe për blerjen e apartamentit nga ana e babait të tij.

Nëse mbledhim shumën e përfituar nga të ardhurat e shitjes së dyqanit, tokës dhe apartamentit rezulton se shuma totale e përfituar është 1,600,000 lekë, nëse kësaj shume i zbrisim dhe shumën 500,000 lekë e pretenduar se i është dhuruar subjektit të rivlerësimit si dhe shumën 500,000 lekë për shitjen e truallit i cili është shitur në vitin 2002 mbetet një diferencë prej

600,000 lekë e cila është e pamjaftueshme për të mbuluar shumën e blerjes së këtij apartamenti nga babai i tij.

Për sa më sipër subjekti i rivlerësimit nuk provoi përpara Komisionit me dokumentacion provues dhurimin e shumës prej 500,000 lekësh dhe burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e apartamentit të tij apo të babait të tij.

Në lidhje me këto konstatim pas kalimit të barrës të provës subjekti i rivlerësimit depozitoi kontratë huaje, nr. ***, datë 11.12.2018, nëpërmjet së cilës deklarohet se, z. N.Gj., i ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën prej 500,000 lekësh në janar të vitit 2001 dhe afati i kthimit është janar i vitit 2035 si dhe një raport ekspertize të hartuar nga znj. V.K., kontabël i miratuar.

Subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, gjatë gjithë hetimit administrativ por dhe në shpjegimet e tij ka deklaruar se shuma 500,000 lekë i është dhuruar nga babai dhe vëllai i tij ndërkohë pas kalimit të barrës së provës ai depoziton një kontratë huaje parashikimet e të cilës janë në kundërshtim me deklaratimet e tij në deklaratën “Vetting” por dhe gjatë gjithë procesit të rivlerësimit.

Për sa më sipër trupi gjykues duke analizuar përgjigjet e subjektit gjatë gjithë hetimit administrativ dhe dokumentacionit të dorëzuar pas kalimit të barrës së provës arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaratim të rremë në lidhje me dhurimin e shumës 500,000 lekë nga familjarët e tij si për shkak se nuk ka provuar me dokumentacion provues dhënien e kësaj shume nga ana e familjarëve të tij dhe për rrjedhojë kjo shumë nuk do të konsiderohet si burim për blerjen e këtij apartamenti.

b. Për të vërtetuar aftësinë paguese të subjektit të rivlerësimit, për shumën 1,400,000 lekë të kursyer nga ana e Komisionit është bërë analiza e mëposhtme financiare:

- **Pasuritë:**
- Apartament banimi me sipërfaqe 60 m², me vlerë 1900 000 lekë.
- **Të ardhurat nga paga periudha 1995 - qershor 2001:**

Viti	Paga neto (lekë)
1995	58.491
1996	175.872
1997	173.604
1998	249.290
1999	267.527
2000	348.173
2001	182.197
TOTALI	1.455.154

- **Shpenzimet jetike** për periudhën 1995 - qershor 2001:

Shpenzimet mesatare mujore për konsum janë llogaritur si më poshtë:

- për periudhën 1995 -1997 janë llogaritur me vlerën 5,000 lekë në muaj (3 x12 muaj x 5,000 lekë), gjithsej në vlerën 180,000 lekë.
- Periudha 1998 - 2001 janë llogaritur me 10,000 lekë në muaj (41 muaj x 10,000 lekë) gjithsej shuma 410,000 lekë, në total vlera **590,000 lekë**.

- **Shpenzime për mobilimin e apartamentit** në vitin 200, deklaruar në përgjigjen e pyetësorit të datës 25.10.2018, gjithsej në vlerën **120,000 lekë**.

Bazuar në të dhënat e mësipërme rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura në total në shumën **1,455,154 lekë**, ndërkohë shpenzimet në total kanë qenë në shumën **710,000 lekë**, diferenca midis këtyre dy shumave prej **745,154 lekësh**, shumë e cila mund të këtë shërbyer si burim për blerjen e këtij apartamenti.

Në lidhje me këtë konstatim pas kalimit të barrës të provës, subjekti i rivlerësimit, depozitoi raport ekspertize të hartuar nga znj. V.K., kontabël i miratuar.

Komisioni vlerëson se raporti i ekspertes V.K. nuk duhet të merret në konsideratë për shkak se:

- Në këtë raport janë përfshirë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe të familjarëve të tij, ndërkohë ai vetë ka deklaruar se të ardhurat e familjarëve të tij për blerjen e këtij apartamenti ka qenë shuma 500,000 lekë e cila është trajtuar më lart.
- Në aktin e ekspertit balancat pozitive në fund të çdo vit janë konsideruar si gjendje e likuiditeteve në fillim të vitit pasardhës duke u konsideruar si fonde për mbulimin e shpenzimeve të vitit pasardhës. Gjendjet në fund të vitit të përfshira në raport nuk korrespondojnë me gjendjet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ por dhe në deklaratat e interesave private ndër vite të cilat përbëjnë provë në kuptim të nenit 32/5 të ligjit nr. 84/2016.
- Nga ana e ekspertit, pa asnjë lloj dokumentacioni provues, në raport nuk janë llogaritur shpenzimet jetike duke konkluduar se familja e subjektit të rivlerësimit i ka mbuluar me të ardhurat që ka siguruar nga toka që ka pasur në përdorim bazuar në vërtetimi e datës 29.12.2018, të Kryetarit të Fshatit Gjorem, ky vërtetim nuk mund të përbëjë provë pasi ai është thjesht deklarativ dhe nuk shoqërohet me asnjë dokumentacion provues për të vërtetuar të ardhurat apo produktet e siguruara si dhe nëse këto produkte apo të ardhura kanë qenë në masën e nevojshme për të mbuluar shpenzimet jetike të subjektit të rivlerësimit dhe familjarëve të tij si dhe nëse për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore përkatëse.
- Në këtë raport eksperti ka përfshirë dy herë shumën 439,951 lekë, njëherë e ka përfshirë si paga të vitit 2001 dhe njëherë e ka përfshirë të ndarë si pagë deri në maj të vitit 2001. Gjithashtu

eksperti ka përfshirë si të ardhur dhe shumën 500,000 lekë e cili prezumohet që ka ardhur nga të ardhurat e familjarëve të subjektit të rivlerësimit dhe si e tillë nuk mund të përfshihej në këtë analizë. Pra në total eksperti deri në vitin 2001 në mënyrë të padrejtë ka shtuar shumën 939,951 lekë të cilën nëse e heqim si të ardhura në vetë aktin e ekspertimit në fund do të kemi një rezultat negativ për blerjen e apartamentit të subjektit të rivlerësimit.

Për sa më sipër, Komisioni, pasi analizoi raportin e ekspertizës i cili nuk është i saktë, dokumentacion e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën **1,154,846 lekë** për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti.

2. Bazuar në Udhëzimin Nr. 5, datë 31.05.2001, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive, të vlerave të tregut të lirë të banësive dhe të koeficientit "k"” çmimi në tregun e lirë për apartamentet në Tiranë në vitin 2001 është përcaktuar në shumën 56,306 lekë/m².

Referuar këtij çmimi vlera e apartamentit të subjektit të rivlerësimit i cili ndodhet në një zonë të mirë të Tiranës është 3,378,360 lekë gati dyfish më e lart se çmimi i blerjes të tij. Nëse kësaj vlere i shtojmë dhe vlerën e sipërfaqes së verandës prej 47.74 m², çmimi i blerjes së këtij apartamenti nga ana e subjektit të rivlerësimit rezulton shumë më i vogël se çmimi i shitjes së banësive në tregun e lirë.

Nga ana e subjektit të rivlerësimit, më datë 10.09.2018, është sqaruar se çmimi i shitjes ka qenë i ulët për arsye se apartamenti i tij ndodhet në katin e shtatë në një pallat pa ashensor dhe se i gjithë apartamenti është i mbuluar me panele sanduiç fakt tjetër ndikues në çmimin e tij.

Këto shpjegime të subjektit të rivlerësimit nuk janë të mjaftueshëm për të vërtetuar çmimin e shitjes në një vlerë shumë më të vogël se vlera reale e shitjes.

Për sa më sipër, rezulton se kemi të bëjmë me një veprimi financiar të pajustificuar dhe të pambështetur në parimet e ekonomisë së tregut (parimi i fitimit), përderisa shitësi shet me një çmim shumë më të ulët mallin.

Në lidhje me këto konstatime pas kalimit të barrës të provës subjekti i rivlerësimit depozitoi:

- Kontratë shitje nr. ***, datë 27.12.2000, nëpërmjet së cilës shoqëria “****” sh.p.k., me administrator z. I.Xh. i shet znj. L.Gj. disa apartamente dhe njësi shërbimi ku përfshihet dhe apartamenti i blerë nga subjekti i rivlerësimit i cili është shitur për shumën 1,400,000 lekë.

Në këtë kontratë përcaktohet se punimet e brendshme të apartamenteve do të përfundohen nga blerësi i kësaj prone. Gjithashtu kjo kontratë është lidhur midis dy personave që kanë lidhje të ngushta familjare pasi ato kanë qenë bashkëshort.

- Raport vlerësimi përgatitur nga studio vlerësuese “****” sh.p.k.

Komisioni vlerëson se ky raport nuk duhet të merret në konsideratë për shkak se:

1. Eksperti për të llogaritur çmimin në tregun e lirë të këtij apartamenti në vend që ti referohej çmimit të tregut të lirë të parashikuar nga Udhëzimi i Entit Kombëtar të Banesave i është referuar koston së ndërtimit të përcaktuar në të njëjtin Udhëzim.

Eksperti nuk mund t'i referohej koston së ndërtimit për të llogaritur çmimin e tregut pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në cilësinë e ndërtuesit të këtij apartamenti.

2. Eksperti nuk i është referuar kontrata të ngjashme të lidhur nga banorët e tjerë të këtij pallati me firmën e ndërtimit.
3. Eksperti nuk ka llogaritur vlerën e sipërfaqes së verandës të këtij apartamenti.

Për sa më sipër, Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provoj bindshëm se çmimi i blerjes së apartamentit të tij ka qenë i përafërt me çmimin e tregut në atë zonë apo me çmimin e shitjes në të njëjtin pallat. Në këto rrethana Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit e ka blerë apartamentin në një çmim shumë më të ulët se çmimi i tregut të lirë i cili përbën një veprimi financiar të pajustificuar dhe të pambështetur në parimet e ekonomisë së tregut (parimi i fitimit), përderisa shitësi shet me një çmim më të ulët mallin, duke e vënë subjektin e rivlerësimit në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm dhe të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me çmimin e blerjes së këtij apartamenti.

3. **Në lidhje me mobilimin** e këtij apartamenti subjekti i rivlerësimit në pyetësorin standard ka deklaruar se vlera e tij është në shumën 7.000 euro.

Në lidhje me këtë vlerë i është kërkuar subjekti të rivlerësimit të deklaroj shpenzimet e kryera në vite në lidhje me mobilimin e këtij apartamenti. Ai ka deklaruar se nuk e mban mend. Është ripyetur sërish subjekti i rivlerësimit. Në përgjigjet e datës 19.10.2018 ai ka deklaruar se: Shpenzimet janë kryer si më poshtë:

Vlera 50,000 lekë, kursime nga paga, periudha 2002-2004.

Vlera 50,000 lekë, kursime nga paga, periudha 2005-2006.

Vlera 200,000 lekë, kursime nga paga, periudha 2007-2009.

Vlera 300,000 lekë, kursime nga paga, për vitet 2010-2012.

Ndërkohë, më datë 30.10.2018, ai ka deklaruar se në vitin 2001 ka shpenzuar për mobilimin e këtij apartamenti shumën 120,000 lekë.

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit në lidhje me shpenzimet e mobilimit të apartamentit i ka dhënë Komisionit përgjigje të ndryshme dhe kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit.

Në përfundim konstatohet se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 1,154,846 lekë për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për pagesën e apartamentit.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën “Vetting” në lidhje me burimin e ligjshëm që ka shërbyer për blerjen e këtij apartamenti.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me çmimin e blerjes së këtij apartamenti.
- iv. Subjekti i rivlerësimit i ka dhënë Komisionit përgjigje të ndryshme dhe kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me shpenzimet për mobilimin e këtij apartamenti

❖ **Apartament** banimi, me sipërfaqe 47.74 m², ndodhur në, Rr. “***”, me vlerë 600,000 lekë, fituar me leje legalizimi nr. ***, datë 23.04.2013. Subjekti deklaron se ndërtimin e shtesës e ka filluar në vitin 2011 duke investuar çdo vit nga pak.

Burimi i krijimit sipas deklaratës “Vetting”:

Kursime nga paga

Hetimi i kryer nga ana e Komisionit²

Konstatimi i ILDKPKI-së: Rezulton që subjekti i rivlerësimit, z. Alfred Gjoni, nuk ka deklaruar në kohë krijimin e kësaj sipërfaqeje banimi prej 47.4 m², për të cilën është aplikuar në vitin 2006 dhe prezumohet se ky ndërtim ka qenë i përfunduar në këtë moment. Gjithashtu ka mosdeklarim dhe fshehje reale të shpenzimeve të kryera në këtë apartament, duke marrë parasysht se vlerat e investimeve për ndërtimet pa leje, të cilat llogariten nga ALUIZNI për të nxjerrë detyrimin e subjektit për të paguar taksën e infrastrukturës, marrin koston mesatare të ndërtimit, konkretisht për shtesën në fjalë është llogaritur një shpenzim për sipërfaqe ndërtimit në vlerën prej 1,309,938 lekësh, pa llogaritur arredime dhe mobilim të kësaj banese, ndërkohë që subjekti në deklaratën “Vetting” deklaron kosto jo më shumë se 600,000 lekë.

➤ ² Shkresë nr. *** prot., datë 01.02.2018, drejtuar ZVRPP-ve

Shkresë nr. *** prot., datë 21.02.2018, kthim përgjigje, ZVRPP Tiranë.

ZVRPP Tiranë, me shkresë nr. *** prot., datë 21.02.2018, na dërgo të njëjtat të dhëna.

➤ Shkresë nr. ***, datë 01.02.2018, drejtuar ALUIZNI-t.

Me shkresë nr. *** prot., datë 14.02.2018, ALUIZNI-t ia delegon për trajtim kërkesën e Komisionit, Drejtorisë së ALUIZNI-t Tirana 2 dhe drejtorisë së ALUIZNI-t Veri duke qenë se z. Alfred Gjoni dhe z. A.Gj. rezultojnë aplikues në procesin e legalizimeve.

Me shkresë nr. *** prot., datë 27.02.2018, drejtorja e ALUIZNI-t Veri na informon se:

Praktika e legalizimit në këtë drejtori është në emër të A.Q.Gj.

➤ Shkresë nr. *** prot., datë 21.02.2018, drejtuar drejtorisë ALUIZNI-t TIRANA 2.

Me shkresë nr. *** prot., datë 20.02.2018, Drejtorja ALUIZNI-t Tirana 2 na informon se:

Z. Alfred Gjoni, ka vetëdeklaruar për legalizimin e ndërtim informal me adresë Rruga “***”, Nj. ***, Tiranë dhe është pajisur me leje legalizimi nr. *** prot., datë 23.04.2013.

Me shkresë nr. *** prot., datë 26.02.2018, ALUIZNI-t Tirana 2 na konfirmon dhënien e dokumentacionit më shkresë nr. *** prot., datë 20.02.2018.

Fshehje të shtesës së apartamentit me sipërfaqe 47.74 m² si dhe vlerës së shpenzuar në deklarinimin e interesave private periodike/vjetore 2006, pasi ALUIZNI konfirmon që vetëdeklarimi është kryer në vitin 2006.

Deklarim i rremë dhe mungesë burimi i ligjshëm financiar, për apartamentin me sip.47.74 m² pasi në deklarinimet ndër vite vetëm në vitin 2014 ka deklaruar vlerën 50,000 lekë.

Deklarimi i rremë dhe mungesë burimi i ligjshëm financiar pasi në deklaratën e rivlerësimit ka deklaruar vlerën 600,000 lekë, kurse sipas ALUIZNI-t vlera e përlllogaritur është 1,309,938 lekë.

Arsyetim ligjor

Apartamenti i banimit është përfituar me leje legalizimi, nr. ***, datë 23.04.2013, dhe është regjistruar pranë ZVRPP-së Tiranë, më datë 08.07.2013, me të dhënat shtesë kati mbi apartament pallati ekzistues.

1. Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se këtë apartament ka filluar ta ndërtojë nga viti 2011.

Ndërkohë nga hetimi administrativ ka rezultuar se:

- Me shkresë nr. *** prot., datë 20.02.2018, drejtorja e ALUIZNI-t Tirana 2, na informon se:

*Z. Alfred Gjoni ka vetëdeklaruar **me formular, nr. *** prot., datë 21.09.2006, si dhe me formular nr. ***, datë 04.10.2006, për legalizimin e të njëjtit ndërtim informata, l me adresë, Rr: “***”, Njësia Administrative Nr. ***, Tiranë dhe është pajisur me leje legalizimi nr. ***, datë 23.04.2013.***

- Referuar deklaratave të interesave private (DIP) të subjektit të rivlerësimit rezultoi se ky ndërtimi është deklaruar për herë të parë në DIP/2008 ndërkohë në DIP/2014 subjekti i rivlerësimit deklaroi se e ka përfunduar totalisht në vitin 2014.

- Në lidhje me këtë apartament subjektit i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ ka deklaruar se:

Sqaroj se shtesa është ndërtuar me konstruksion të lehtë e pa themel, duke filluar që nga viti 2001, ajo qëndron në verandën e apartamentit të blerë dhe është pjesë intergrale e tij. Kosto e ndërtimit të përgjithshëm ka qenë në vlerën 600,000 lekë dhe është paguar nga kursimet e mia të punës pas vitit 2001. Si konstruksion i jashtëm ka përfunduar në vitin 2006, kohë në të cilën edhe kam aplikuar pranë Agjencisë së Legalizimit. Pjesa e parë e kësaj shtese me sipërfaqe 23 m² është përfunduar në vitin 2004, ndërsa pjesa tjetër me sipërfaqe 24.74m² është përfunduar në vitin 2006. Pajisja me orendi dhe rregullimi i brendshëm është i mëvonshëm. Për sa i përket citimit tim në deklarinimin se e kam ndërtuar në 2011 ka qenë për shkak se në këtë vit unë kam bërë përfundimisht edhe arredimin e kësaj shtese dhe mbylljen e saj përfundimtare.

Argumentimi i tij se në deklaratën “Vetting” ka deklaruar si vit ndërtimi vitin 2011, për shkak se në këtë vit ka bërë përfundimisht arredimin e saj, nuk qëndron pasi ndërtimi dhe arredimi janë dy koncepte teknike që nuk kanë lidhje me njëra tjetrën, për më tepër bazuar në provat e administruar gjatë hetimit administrativ, më konkretisht fotove të dorëzuara pranë ALUIZNI-t për qëllim legalizimi si dhe planimetrisë administruar nga Komisioni, me shkresën nr. *** prot., të ALUZINI-t, rezulton se objekti është ndërtuar në vitin 2004 dhe ka qenë i përfunduar dhe arreduar shumë kohë përpara vitit 2011.

- Për të sqaruar kohën e ndërtimit të kësaj shtese është ripyetur dhe njëherë subjekti i rivlerësimit i cili deklaroi se: *“Pjesa e parë e shtesës është përfunduar në vitin 2004, ndërsa pjesa tjetër me sip. 24.74 m² është përfunduar në vitin 2006 pjesërisht dhe përfundimisht në vitin 2009”*.

Sërish ky deklaram i subjektit të rivlerësimit nuk është i saktë pasi bazuar në dokumentacionin e administruar, shtesa ka përfunduar minimalisht **në vitin 2007** kohë ku rezulton të jetë bërë oponenca teknike për këtë shtesë, e cila i është dërguar subjektit të rivlerësimit me shkresë nr. *** prot., datë 05.09.2007. Gjithashtu nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk rezulton të ketë deklaram në DIP/2009 në lidhje me këtë shtesë.

Për sa më sipër rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën “Vetting” në lidhje me vitin e ndërtimit të apartamentit, me qëllim që të fshehë burimin e ligjshëm të ndërtimit të kësaj shtese, ka dhënë përgjigje të ndryshme dhe kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit si dhe nuk ka deklaruar këtë apartament në deklaratat e interesave private 2003 - 2008.

Në lidhje me këto konstatim pas kalimit të barrës të provës subjekti i rivlerësimit depozitoi:

- Raport vlerësimi përgatitur nga studio vlerësuese “****” sh.p.k., i cili nuk përputhet me:
 - a. Të dhënat e administruar gjatë hetimit administrativ nga ku rezulton se apartamenti ka qenë i përfunduar përpara vitit 2007 (*për më tepër në raport, viti 2009, është marrë si referencë sipas kërkesës së subjektit të rivlerësimit dhe nuk është rezultat i aktit të ekspertimit*) për sa kohë është bërë oponencë teknike.
 - b. Deklaramen noteriale, nr. ***, të depozituar nga subjekti i rivlerësimit nga ku rezulton se në vitin 2007 ka shpenzuar shumën 600,000 lekë si dhe me vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.
 - c. Eksperti në llogaritjen e kostos së këtij apartamenti nuk i është referuar kosto të ndërtimit të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave në udhëzimet e viteve përkatëse ku pretendohet të jetë ndërtuar shtesa ashtu sikundër ka bërë me apartamentin me sipërfaqe 60 m².
- Deklaramen noteriale, nr. ***, nëpërmjet së cilës, shtetasi S.M., deklaroi se në maj të vitit 2007 ka bërë punime në një papafingo me dru, me sipërfaqe 45 m², me çmim total 600,000 lekë, në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

Referuar kësaj deklarata rezulton se apartamenti i subjektit të rivlerësimit në vitin 2007 ka qenë i ndërtuar pasi, z. M., deklaron se ka bërë punime në një papafingo.

Dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit nuk provon të kundërtën e rezultateve të hetimit administrativ, për më tepër ky dokumentacion është kontradiktor.

2. Bazuar në formularin e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet informale, rezulton se vlera e investimit e kësaj shtese është 1,309,938 lekë (47.74 m²x27,439 lekë) e cila nuk korrespondon me vlerën e deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me këtë mospëputhje si dhe me vlerën totale të investimit për ndërtimin e kësaj shtese, më datë 04.09.2018, subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion shtesë. Më datë 10.09.2018 subjekti i rivlerësimit nuk jep asnjë sqarim në lidhje me vlerën e investimit të kryer nga ana e tij për këtë shtesë.

Nëse i referohemi udhëzimeve të Entit Kombëtar të Banesave për vitin 2004 dhe 2006 kostoja e ndërtimit për shtesën është si më poshtë:

Në vitin 2004 bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit ai ka ndërtuar 23 m², vlera e investimit të të cilit, bazuar në Udhëzimin e Entit Kombëtar të Banesave, është 23m²x 24,446 lekë=**562,258 lekë**.

Në vitin 2006 bazuar në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit ai ka ndërtuar 24.74 m², vlera e investimit të të cilit, bazuar në udhëzimin e Entit Kombëtar të Banesave, është 24.74m²x 25,262 lekë=**625,234.5 lekë**.

Në total subjekti i rivlerësimit mund të ketë investuar mesatarisht **vlerën 1,187,492.5 lekë**.

Është ripyetur subjekti i rivlerësimit në lidhje me vlerën e investimit dhe të shpenzimeve për mobilimin e kësaj shtese. Më datë 19.10.2018, ai ka deklaruar se: *Shpenzimi total për ndërtimin e kësaj shtese ka qenë në vlerën 600,000 lekë, i ndarë në dy pjesë, përkatësisht 200,000 lekë për vitet 2002 - 2004 dhe 400,000 lekë për vitin 2006 - 2009. Në lidhje me mobilimin ai deklaron se ka shpenzuar vlerën 100,000 lekë për vitin 2002 – 2004, 100,000 lekë në vitin 2005 dhe 100,000 lekë për periudhën 2006 - 2009.*

Deklarimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me vlerën e investimit nuk përputhet me vlerat mesatare të përcaktuar nga Enti Kombëtar i Banesave. Gjithashtu periudha kohore e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit nuk përputhet me dokumentacionin e administruar nga ana e Komisionit nga ku rezulton se kjo shtesë ka qenë e përfunduar në vitin 2006.

Për sa i përket mobilimit të këtij apartamenti subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklaram e tij duke thënë se ai është bërë gjatë viteve 2002 - 2009 ndërkohë në deklaramin e mëparshëm kishte deklaruar se ai është bërë në vitin 2011.

Si burimi për ndërtimin e kësaj shtesë dhe mobilimin e saj, subjekti i rivlerësimit, deklaroi kredinë e marrë pranë “Raiffeisen Bank” dhe kursime nga paga, ndërkohë referuar deklarimeve të tij në DIP/2004, kredinë e marrë nga “Raiffeisen Bank” e ka deklaruar se e ka marrë për pushime.

3. Analiza financiare

Nga ana e Komisionit është kryer një analizë financiare në lidhje me mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të ndërtuar këtë shtesë si më poshtë:

Viti 2004

Nr.	Përshkrimi		Viti 2004
	Pasuritë		200,000
1		Shtesë verande, me sip. 47 m ² , për legalizim sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit	200,000
	Të ardhurat		876,462
1		Paga	876,462
	Shpenzimet		796,401
1		Vlera e arredimit të shtëpisë sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit	150,000
2		Shpenzime transporti për në Kurbin bazuar në deklarin e subjektit të rivlerësimit	156,000
3		Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së	490,401
	Diferenca		(119,939)

Viti 2004, nëse vlerën e investimit të shtesës e llogarisim sipas Entit Kombëtar të Banesave

Nr.	Përshkrimi		Viti 2004
	Pasuritë		562,258
1		Shtesë verande, me sip. 47 m ² , për legalizim sipas kostos mesatare të entit të banesave	562,258
	Te ardhurat		876,462
2		Paga	876,462
	Shpenzimet		796,401
1		Vlera e arredimit të shtëpisë sipas deklarimeve të subjektit të rivlerësimit	150,000
2		Shpenzime transporti për në Kurbin bazuar në deklarin e subjektit të rivlerësimit	156,000

3		Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së	490,401
Diferenca			(482,197)

Viti 2005

Nr.	Përshkrimi		Viti 2005
Pasuritë			-50,080
1		LIKUIDITETE	-50,080
Të ardhurat			847,440
2		Paga	847,440
Detyrimet			324,356
1		Kredi në "Raiffeisen Bank"	400,000
2		Shlyerje këste kredie	-75,644
Shpenzimet			1,193,464
1		Interesa të kredisë	26,503
2		Vlera e arredimit të shtëpisë	150,000
3		Shpenzime transporti për në Kurbin	156,000
4		Shpenzime jetike	653,868
5		Shpenzime udhëtimi jashtë vendit (pyetësori)	207,093
Diferenca			28,412

Viti 2006

Nr.	Përshkrimi		Viti 2006
Pasuritë			450,964
1		Shtese verandë, me sip. 47 m ² për legalizim	400,000
2		LIKUIDITETE	50,964
Të ardhurat			834,064
1		Paga e subjektit të rivlerësimit	834,064
Detyrimet			-197,545
1		Shlyerje e kesteve të kredisë	-197,545
Shpenzimet			1,166,511
1		Interesa të kredisë	28,407
		Vlera për arredimin e shtëpisë	100,000
1		Shpenzime transporti për në Kurbin	156,000
2		Shpenzime jetike	653,872

3	Shpenzime udhëtimi jashtë vendit (pyetësori)	228,232
4	Për studimet master në Universitetin "Hasan Prishtina", Kosovë.	
Diferenca		(980,956)

Viti 2006 nëse vlerën e investimit të shtesës e llogarisim sipas Entit Kombëtar të Banesave

Nr.	Përshkrimi	Viti 2006
Pasuritë		676,198.5
1	Shtesë verande, me sip. 47 m ²	625,234.5
2	Shtesë/pakësim likuiditeteve në bankë	50,964
Të ardhurat		834,064
1	Paga	834,064
Detyrimet		-197,545
1	Këstet e kredisë	197,545
Shpenzimet		1,166,511
1	Interesa të kredisë	28,407
2	Vlera e arredimit të shtëpisë	100,000
3	Shpenzime transporti për në Kurbin	156,000
4	Shpenzime jetike sipas ILDKPKI-së	653,872
5	Shpenzime udhëtimi jashtë vendit (pyetësori)	228,232
Diferenca		(1,206,190.5)

Në lidhje me këto konstatim pas kalimit të barrës të provës subjekti i rivlerësimit depozitoi:

- Raport vlerësimi përgatitur nga studio vlerësuese "***" sh.p.k., i cili siç është sqaruar më lartë nuk mund të merret si provë për sa kohë ka të dhëna që nuk përputhen me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ nga institucionet shtetërore dhe nga subjekti i rivlerësimit si dhe me vetëdeklarimet e subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.
- Raport ekspertize të hartuar nga, znj. V.K., kontabël i miratuar, i cili nuk mund të merret si provë pasi:
 - a- Në lidhje me vlerën e shtesës dhe viteve të ndërtimit të saj i është referuar raportit të vlerësimit përgatitur nga studio vlerësuese "***" sh.p.k.
 - b- Në tabelën nr. *** të raportit ekspertizës, vlera prej 606,447 lekësh, e shtesës me sip. 47,74 m², është llogaritur si shpenzim me një shumë të barabartë për çdo vit prej 75,806 lekësh për periudhën 2002 - 2009 (8 vite), ndërsa në pyetësor subjekti ka deklaruar se pjesa e parë e kësaj shtese që është rreth 23 m² është përfunduar në vitin 2004 me vlerë

200,000 lekë, ndërsa pjesa tjetër me sip. 24.74 m² është përfunduar në vitin 2006 me vlerë 400,000 lekë.

Komisioni pasi analizoi raportin e ekspertizës i cili nuk është i saktë, dokumentacion e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, vlerëson se ai ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e shtesës.

Në përfundim konstatohet se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e shtesës.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën “Vetting” në lidhje me burimin e ligjshëm të të ardhurave për blerjen e këtij apartamentit.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë në deklaratën “Vetting” në lidhje me vitin e ndërtimit të këtij apartamenti.
- iv. Subjekti i rivlerësimit i ka dhënë Komisionit përgjigje të ndryshme dhe kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me mobilimin e këtij apartamenti

❖ Në lidhje me likuiditet

Hetimi i kryer nga Komisioni³

Arsyetimi ligjor

1. Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2005 ka deklaruar se ka marrë kredi pranë “Raiffesien Bank” shumën 400,000 lekë për pushime verore.

“Raiffeisen Bank”, me shkresë nr. *** prot., datë 7.02.2018 na informon se:

Subjekti i rivlerësimit ka qenë kredimarrës për një **kredi me vlerë 400,000 lekë marrë më datë 18.07.2005 dhe mbyllur më datë 18.07.2007**. Në lidhje me shlyerjen e kësaj kredie subjekti i rivlerësimit në deklaratat e interesave private ndër vite nuk ka qenë i saktë pasi ai ka

➤ ³ Shkresë nr. *** prot., datë 01.02.2018 drejtuar të gjitha bankave të nivelit të dytë.

“Raiffeisen Bank”, me shkresë nr. *** prot., datë 07.02.2018, na informon se:

Z. Alfred Gjoni ka llogari në lekë, në valutë dhe ka qenë kredimarrës për një kredi me vlerë 400,000 lekë marrë më datë 18.07.2005 dhe mbyllur më datë 18.07.2007.

“ProCredit Bank”, me shkresë nr. *** prot., datë 20.02.2018, na informon se:

Z. Alfred Gjoni ka pasur llogari kursimi, rrjedhëse dhe overdraft në shumën 170,000 lekë.

➤ Shkresë nr. *** prot., datë 21.2.2018, drejtuar “Raiffeisen Bank”.

Me shkresë nr. *** prot., datë 27.02.2018, “Raiffeisen Bank” na informon se banka nuk disponon dokumente pasi ato janë asgjësuar bazuar në rregulloren për arkivimin e dokumentacionit në “Raiffeisen Bank” mbas plotësimit të afatit të ruajtjes 12 vjet.

deklaruar shlyerjen e saj në vitin 2009, vit i cili nuk përputhet me të dhënat e bankës nga ku rezulton se kjo kredi ka përfunduar në vitin 2007.

Nga ana e Komisionit është kryer edhe një analizë financiare në lidhje me shlyerjen e kësaj kredie si më poshtë:

Viti 2005

Nr.	Përshkrimi		Viti 2005
	Pasuritë		-50,080
4		LIKUIDITETE	-50,080
	Të ardhurat		847,440
1		Paga	847,440
	Detyrimet		324,356
1		Kredi në "Raiffeisen Bank"	400,000
		Shlyerje këste kredie	-75,644
	Shpenzimet		1,193,464
2		Interesa të kredisë	26,503
		Vlera e arredimit të shtëpisë	150,000
		Shpenzime transporti për në Kurbin	156,000
		Shpenzime jetike	653,868
		Shpenzime udhëtimi jashtë vendit (pyetësori)	207,093
	Diferenca		28,412

Viti 2006

Nr.	Përshkrimi		Viti 2006
	Pasuritë		450,964
2		Shtesë verande, me sip. 47 m ² , për legalizim	400,000
4		LIKUIDITETE	50,964
	Të ardhurat		834,064
1		Paga e subjektit të rivlerësimit	834,064
	Detyrimet		-197,545
		Shlyerje e kësteve të kredisë	-197,545
	Shpenzimet		1,166,511
2		Interesa të kredisë	28,407
		Vlera e arredimit të shtëpisë	100,000
		Shpenzime transporti për në Kurbin	156,000
		Shpenzime jetike	653,872

	Shpenzime udhëtimi jashtë vendit (pyetësori)	228,232
Për studimet master në Universitetin "Hasan Prishtina", Kosovë.		
Diferenca		(980,956)

Viti 2007

Nr.	Përshkrimi	Viti 2007
Pasuritë		-168,302
4	LIKUIDITETE	-168,302
Të ardhurat		820,911
1	Paga e subjektit të rivlerësimit	820,911
Detyrimet		-126,811
	Shlyerje e kësteve të kredisë	-126,811
Shpenzimet		915,083
2	Interesa të kredisë	5,464
	Shpenzime transporti për në Kurbin	156,000
	Shpenzime jetike	653,868
	Shpenzime udhëtimi jashtë vendit (pyetësori)	99,751
Diferenca		(52,681)

Nga analiza e mësipërme rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shlyerjen e kësaj kredisë.

Në lidhje me këto konstatim pas kalimit të barrës të provës, subjekti i rivlerësimit, depozitoi raport ekspertize të hartuar nga znj. V.K., kontabël i miratuar, i cili nuk mund të merret si provë bazuar në argumentet e trajtuar më lartë në këtë vendim.

2. Nga nxjerrja e llogarisë të subjektit të rivlerësimit në "ProCedit Bank", rezulton se:

- Më datë 27.07.2009, subjekti i rivlerësimit, ka depozituar **shumën 405,000** lekë në *cash* dhe e ka kaluar për llogari të z. E.Ç.
- Më datë 20.03.2010, z. Sh.Ç., depoziton shumën **500,000** lekë në llogarinë e subjektit të rivlerësimit. Kjo shumë i transferohet, z. E.Ç., në po të njëjtën datë.
- Më datë 12.04.2010, subjekti i rivlerësimit, transferon shumën prej 91,500 lekësh në llogari të z. E.Ç.

Në lidhje me këto transferta, subjektit të rivlerësimit, iu kërkua informacion shtesë.

Në përgjigjen e tij ai sqaron se: *Shtetasi E. (Sh.) Ç., ka qenë ish-shoferi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin. Nga dokumentacioni që ka siguruar post kërkesës sonë rezulton i njëjti*

person. Është emëruar në vitin 2008 në detyrën e shoferit prej ish-kancelares së Gjykatës (për kohën Kryetari i Gjykatës nuk kishte kompetenca të emëronte shoferin), dhe është larguar në vitin 2011. Nuk mban mend në detaje, qëllimin konkret të dhënies së borxhit nga ana e tij, por shuma përkatëse përbën pjesën më të qenësishme të cashit që ka pasur në banesë për kohën. Për sa i përket parasë të dhënë borxh, e cila në dy transfertat shkon në shumën prej 500,000 lekësh, është pjesë e kursimeve të tij të deklaruara. Transaksioni i datës 20.03.2010, duhet të ketë qenë përpjekje për të larë borxhin nga ana e z. E.Ç., por që për shkak të gjendjes së tij për kohën, për sa kujton duhet t'ia ketë rikthyer deri në një përmirësim të situatës së tij. Shlyerja e kësaj shume është realizuar më pas me këste në cash, në një periudhë të mëvonshme. Nga përgjigjet e subjektit të rivlerësimit rezulton se ai i ka dhënë hua shumën 500, 000 lekë, z. E. (Sh.) Ç., shumë e cila sipas deklarimeve të tij i është kthyer me këste në cash. Kjo marrëdhënie huaje nuk rezulton e deklaruar në deklaratën “Vetting” por dhe në të gjitha deklaratat periodike të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit nuk provon me dokumentacion provues kthim e kësaj shume nga ana e z. E.Ç.

Vlerësimi i aftësisë pague për dhënien e borxhit, më datë 27.07.2009, z. E.Ç.

Nr.	Përshkrimi	1 janar - 29 korrik 2009
1	Gjendja e likuiditeteve më datë 1 janar 2009	-180,926
2	Gjendja e likuiditeteve, më datë 29 korrik 2009 (20 285 +(-168 385)	-148,100
	Të ardhurat	618,493
1	Paga e subjektit të rivlerësimit (paga për 7 muaj)	618,493
	Detyrimet	-405,000
1	Dhënë borxh, z.E.Ç.	-405,000
	Shpenzimet	625,000
1	Vlera e arredimit të shtëpisë	0
2	Shpenzime transporti për në Kurbin	91,000
3	Shpenzime jetike	476,000
4	Shpenzime për cel. sipas pyetësorit	58,000
	Diferenca	- 444,333

Viti 2009

Nr.	Përshkrimi	Viti 2009
	Pasuritë	12,143
1	LIKUIDITETE	12,143
	Të ardhurat	1,060,274
1	Paga e subjektit të rivlerësimit	1,060,274
	Detyrimet	-405,000
1	Dhënë borxh, z. E.Ç.	-405,000
	Shpenzimet	1,273,340
1	Vlera e arredimit të shtëpisë	200,000
2	Shpenzime transporti për në Kurbin	156,000

3	Shpenzime jetike	817,340
4	Shpenzime për cel. sipas pyetësorit	100,000
	Diferenca	(630,209)

Nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar dhënien e huas shtetasit E.Ç.

Në lidhje me këto konstatim pas kalimit të barrës të provës subjekti i rivlerësimit depozitoi:

1. Raport ekspertize të hartuar nga znj. V.K., “Kontabël i Miratuar”, i cili nuk mund të merret si provë bazuar në argumentet e trajtuar më lartë në këtë vendim.
2. Deklaratë noteriale, nr. ***, nëpërmjet së cilës subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e z. E.Ç., znj. E.Ç., deklararon se, më datë 27.07.2009, subjekti i rivlerësimit i ka dhënë hua shumën prej 405,000 lekësh z. E.Ç., si dhe, më datë 20.03.2010, shumën prej 500,000 lekësh, ndërsa më datë 12.04.2010 shumën prej 91,500 lekësh. Detyrimi përfundimtar ka qenë shuma 496,500 lekë e cila i është likuiduar subjektit të rivlerësimit me këste për një periudhë 2-vjeçare, në praninë e saj nga bashkëshorti i saj.
3. Deklaratë noteriale, nr. ***, datë 24.12.2018, të shtetasit E.Ç., i cili deklaroi se, më datë 27.07.2009, subjekti i rivlerësimit i ka dhënë hua shumën prej 405,000 lekësh si dhe më datë 20.03.2010 shumën 50,000 lekë, ndërsa më datë 12.04.2010 shumën prej 91,500 lekësh. Detyrimi përfundimtar ka qenë shuma 496,500 lekë e cila i është likuiduar subjektit të rivlerësimit me këste për një periudhë 2-vjeçare

Komisioni çmon se të dy deklaratat e dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, nuk kanë fuqi provuese në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 86/2014, pasi ato nuk shoqërohen me asnjë dokument provues për mënyrën e lëvrimin dhe të përfitimit të kthimit të huas subjektit të rivlerësimit. Komisioni vlerëson se nuk mund të provohen veprime të ndodhura më shumë se 10 vite më parë me deklaratat të vitit 2018 për sa kohë këto veprime nuk rezultojnë të deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit në deklaratat periodike të interesave private por dhe në deklaratën “Vetting”.

Në përfundim konstatohet se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për shlyerjen e kredisë së marrë pranë “Raiffeisen Bank”.
- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” por dhe në asnjë nga deklaratat periodike të interesave private, huan e dhënë z. E.Ç. dhe nuk provon me dokumentacion provues kthimin e huas nga z. E.Ç..
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për dhënien e huas z. E.Ç.

❖ **Në lidhje me pasuritë e padeklaruara, ato në përdorim dhe të dhuruara.**

1. Me shkresë nr. *** prot., datë 14.02.2018, të ZVRPP-së Bulqizë, rezulton se, znj. A.F.Gj., ka në pronësi 9/288 pjesë takuese të një apartamenti me sipërfaqe 83 m².

Këtë apartament bazuar në kartelën e pasurisë e ka përfutuar me trashëgimi më datë 23.03.2015. Apartamenti ndodhet në, ***, me nr. pasurie ***, në Bulqizë.

Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” pjesën takuese të bashkëshortes së tij mbi këtë apartament.

2. Nga ana e ILDKPI-së është administruar një denoncim nga ku rezulton se z. Alfred Gjoni duke filluar nga viti 2009 shfrytëzon një apartament, me adresë, Rr. “****”, ndërtesa nr. ***, hyrja nr. ***, kati ***, Ap. ***, Durrës, pranë Hotel ***.

Subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ i është kërkuar të deklarojë nëse ka në pronësi apo posedim apartament në qytetin e Durrësit, fillimisht nga ana e tij është mohuar të ketë në posedim apo në pronësi apartament në qytetin e Durrësit. Ndërkohë organet ndihmëse kanë informuar Komisionin se subjekti i rivlerësimit frekuenton një apartament në qytetin e Durrësit gjatë periudhës së verës dhe pranverës ndërsa gjatë periudhave të tjera ai përdoret me pak nga ana e tij. Në lidhje me këtë fakt i është rikërkuar informacion subjektit të rivlerësimit. Më datë 19.10.2018 subjekti i rivlerësimit pranon përdorimin e këtij apartamenti duke deklaruar se: *Ai ka qëndruar me pushime për periudha të shkurtra çdo vit nga vitit 2011 - 2012 e në vazhdim në këtë apartament gjatë muajve të verës si i ftuar i familjes Toptani. Pronarët e truallit të pallatit ku është ndërtuar apartamenti R. dhe K.T. janë kumbarët e djalit të tij dhe posedojnë ½ e pallatit duke përfshirë dhe apartamentin e përdorur prej tij. Në vitin 2013 - 2014 ky apartament është blerë nga kushëriri i tij z. H.Gj. me qëllim për t’jua lënë fëmijëve. Kushëriri i tij e lejon të përdori këtë apartament ndërkohë që vetë ai punon dhe jeton në qytetin e Peshkopisë.*

Bazuar në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit ai pranon faktin e përdorimit të këtij apartamenti. Përdorimi i këtij apartamenti nuk është deklaruar nga ana e subjektit të rivlerësimit në pyetësorin standard të dërguar nga ana e Komisioni si dhe ai ka mohuar përdorimin në përgjigjet e dhëna gjatë hetimit administrativ.

Duke qenë se nga ana e subjektit të rivlerësimit është pranuar që ai përdor një apartament në qytetin e Durrësit në pronësi të kushëririt të tij, z. H.Gj., i është kërkuar atij që në zbatim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016 të provoi burimin e ligjshëm të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti nga ana e kushëririt të tij. Më datë 30.10.2018 ai deklaroi si më poshtë:

Përgjashtë periudhën e verës ku mund të ketë shpenzuar disa ditë pushimi gjatë periudhës tjetër të vitit numri i ditëve që mund të ketë konsumuar në këtë apartament është shumë i rrallë kryesisht ndonjë fundjavë. Në total numri i ditëve që shpenzon në këtë apartament është jo më shumë se 20-ditë në vit.

Nëse kohë qëndrimi i tij në këtë apartament ka qenë relativisht më i gjatë se një javë ai mund të ketë paguar kostot e shpenzimeve të energjisë elektrike megjithëse nuk arrin ta mbaj mend.

Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti nga z. H.Gj., subjekti i rivlerësimit, deklaroi se janë nga puna në Greqi si emigrant sezonal, kursimet nga punësimi i tij 30-vjeçar, të ardhurat nga bujqësia dhe blegtoria në fshatin Mustafaj së bashku me familjen dhe kredi të ndryshme që ka marrë apo hua.

Bashkëlidhur përgjigjeve subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion:

- Kontratë shitblerje apartamenti nr. *** datë 10.03.2014 lidhur midis Z. H.Gj. në cilësinë e palës blerëse dhe **Z. B.O.** në cilësinë e palës shitësi i cili është përfaqësuar me prokurë të përgjithshme nga Znj. K.T.

Në nenin “Çmimi i Shitjes”, parashikohet se likuidimi i vlerës 9,750,000 lekë është bërë në vitin 2010 dhe apartamenti është marrë në dorëzim që në vitin 2010.

Bazuar në kontratën e mësipërme rezulton se deklaratimet e subjektit të rivlerësimit të datës 19.10.2018 nuk janë të sakta pasi ai nuk mund të ketë qenë i ftuar i familjes T., gjatë vitit 2011 – 2012, për sa kohë ky apartament nuk ka qenë në posedimin apo pronësinë e kësaj familje.

- Certifikatë për vërtetim pronësie, nr. ***, nga ku rezulton se, z. H.Gj., ka në bashkëpronësi apartamentin, me sipërfaqe 93 m², nr. ***, ***.
- Librezë Pagese Taksat Lokale Për Popullatën e Bashkisë Durrës, në emër të z. H.Gj. Nga ku rezulton se në vitin 2011-2012 është bërë shënimi banor i Dibrës. Në vitin 2013 janë shënuar taksat e paguara ndërsa në vitet e tjera është bosh.
- Mandatarkëtim nr. ***, ku z. H.Gj., ka arkëtuar shumën 4,025 lekë.
- Kërkesë datë 10.03.2014 për regjistrimin e kontratës së shitjes në ZVRPP.
- Mandatarkëtim datë 10.03.2014, ku Z. H.Gj., ka paguar shumën 6,000 lekë të kërkesës për regjistrimin e kontratës së shitjes
- Kartë identiteti e z. H.Gj.
- Vërtetim, datë 26.10.2018, nga “Alpha Bank” nëpërmjet së cilit vërtetohet se z. H.Gj. ka marrë kredi konsumatore në shumën 700,000 lekë më datë 24.06.2016.
- Librezë OSHEE-së në emër të z. B.O.
- Deklaratë dore e pa noterizuar dhe pa vërtetim nënshkrimi si dhe pjesa e fundit e pa identifikueshme në lidhje me datën dhe firmën e deklaruesit nëpërmjet së cilës, z. H.Gj., deklaroi se ka punuar në emigracion në shtetin Grek gjatë viteve 1992-2002, por puna e tij nuk është e licencuar apo e dokumentuar. Edhe sot që është në fshatin e lindjes me profesion mësues ka të ardhura dytësore të pakonfirmuara në bujqësi dhe blegtori.
- Deklaratë dore e datës 05.05.2011 (shifra e fundit nuk lexohet mire) e panoterizuar dhe pa vërtetim nënshkrim të palëve z. H.Gj. dhe z. A.D. të cilët deklarojnë se, z. H.Gj. i ka marrë

hua shumën 2,000,000 lekë për një periudhë 15-vjeçare z. A.D. për blerjen e një apartamenti.

- Deklaratë dore e datës 10.04.2010 (data e korrigjuar) e panoterizuar pa vërtetim nënshkrim të palëve z. H.Gj. dhe z. M.R. të cilët deklarojnë se z. H.Gj. i ka marrë hua shumën 2,200,000 lekë për një periudhë 10-vjeçare, z. M.R. për blerjen e një apartamenti.

Nga dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit nuk provohet burimi i ligjshëm i të ardhurave të z. H.Gj. për blerjen e këtij apartamenti sipas kërkesave të Aneksit D të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Dokumentacioni i dorëzuar në lidhjet me hua-të në shumën totale 4,200,000 lekë është i panoterizuar dhe nuk ka një vërtetim nënshkrimi të palëve për të vërtetuar vullnetin e pavesuar të tyre në deklaratat e hua-së. Një nga deklaratat mund të jetë e vitit 2011 ndërkohë pagesa është bërë në vitin 2010. Nuk provohet me dokumentacion provues marrja e kësaj shume hua nga ana e shtetasit z. H.Gj. Gjithashtu nuk provohet se z. H.Gj. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për pagesën e shumës së mbetur të çmimit të këtij apartamenti. Duke marrë në konsideratë se:

- Subjekti i rivlerësimit ka në përdorim/posedon një apartament në qytetin e Durrësit.
- Subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklarime jo të sakta në lidhje me apartamentin në qytetin e Durrësit duke mohuar fillimisht përdorimin e tij në pyetësorin standard si dhe duke mos deklaruar përdorimin e tij edhe pas pyetjeve shtesë të dërguara gjatë hetimit administrativ.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” posedimin/përdorimin e apartamenti në qytetin e Durrësit.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion provues burimin e ligjshëm të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti nga z. H.Gj.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë i saktë në deklaratimet e tij në lidhje me deklarin e personave që ia kanë lënë në përdorim këtë apartament.
- Subjekti i rivlerësimit pavarësisht ndryshimit të pronarëve të këtij apartamenti ka vijuar përdorimin/posedimin e tij.

Ngrihen dyshime të arsyeshme se subjekti i rivlerësimit mund të ketë në pronësi të fshehur një apartament në qytetin e Durrësit.

Në lidhje me këtë konstatim subjekti i rivlerësimit pasi i kaloi barra e provës sqaron se:

*Mbi apartamentin e përdorur nga ana ime në Durrës për disa ditë në vit, kërkoj të pyetet në cilësi dëshmuese z. H.Gj., lindur dhe banues në Mustafaj, Dibër, me nr. tel. ***, pronar i këtij sendi të paluajtshëm.*

*Tej sa do të pyetet H.GJ., dorëzoj në cilësi prove e me kërkesë timen ndaj tij, deklaratën e bërë para kryeplakut të fshatit, shtetasi H.GJ. si dhe kontratave të huas mes z. H.Gj. dhe shtetasve A.D.D. e M.D.R. Kontratat mbajnë respektivisht nr. ***, dhe nr. ***, realizuar para noterit B.V. Pyetja e këtyre të fundit do të shërbente për të sqaruar sa më plotë këtë çështje.*

Mbi raportin tim me familjen Toptani dhe të drejtën e tyre poseduese të sendit para shitjes ndaj kushëririt tim H.Gj. paraqes në cilësi prove:

1. *Prokurë e përgjithshme, nr. ***, datë 24.12.2007, për shtetasen K.T., tagra të dhëna nga shtetasit B. dhe F.O.*
2. *Kontratë sipërmarrje, nr. ***, datë 23.02.2007, me palë B.E.O. dhe shoqëria “***” sh.p.k., Kavajë.*
3. *Deklaratë noteriale nr. ***, datë 30.11.2006, me deklarues shoqëria “***” sh.p.k., Kavajë dhe B.E.O.*

Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur:

- Deklaratë dorë të shtetasit H.Gj. i cili deklaron mbi të ardhurat e tij por nuk ka vënë në dispozicion dokumentacioni provues
- Kontratë huaje nr. ***, datë 13.12.2018, lidhur midis z. A.D. dhe z. H.Gj. ku deklorohet se, z. H.Gj., ka marrë hua shumën 2,000,000 lekë, më datë 05.05.2010, me afat kthimi deri më datë 04.05.2025.

Kjo kontratë huaje është hartuar vetëm pasi i ka kaluar barra e provës subjektit të rivlerësimit si dhe në këtë kontratë rezulton se z. H.Gj. ka gati 8 vjet që ka marrë hua shumën 2,000,000 lekë dhe nuk ka kthyer asnjë pjesë të saj. Nëse z. H.Gj. do të kishte të ardhurat që deklaron atëherë ai nuk do kishte asnjë arsye për të mos kthyer këtë shumë brenda 8-vjet.

- Kontratë huaje nr. ***, datë 13.12.2018, lidhur midis z. M.R. dhe z. H.Gj. ku deklorohet se z. H.Gj. ka marrë hua shumën 2,200,000 lekë, më datë 10.04.2010, me afat kthimi deri më datë 09.04.2020.

Kjo kontratë huaje është hartuar vetëm pasi i ka kaluar barra e provës subjektit të rivlerësimit si dhe në këtë kontratë rezulton se z. H.Gj. ka gati 8 vjet që ka marrë shumën 2,200,000 lekë hua dhe nuk ka kthyer asnjë pjesë të saj. Nëse, z. H.Gj., do të kishte të ardhurat që deklaron atëherë ai nuk do kishte asnjë arsye për të mos kthyer këtë shumë brenda 8-vjet.

- Deklaratë noteriale nr. ***, datë 30.11.2006, me deklarues shoqëria “***” sh.p.k., Kavajë dhe z. B.E.O.
- Prokurë e përgjithshme nr. ***, datë 24.12.2007, për shtetasen K.T., tagra të dhëna nga shtetasit B. dhe F.O.
- Kontratë sipërmarrje nr. ***, datë 23.02.2007, me palë B.E.O. dhe shoqëria “***” sh.p.k., Kavajë.

Në këto dokumente rezulton se, znj. K.T., ka përfaqësuar z. B. dhe znj. F.O. në marrëdhënien me firmën e ndërtimit.

- Kontratë huapërdorje nr. ***, datë 23.12.2018, nëpërmjet së cilës z. H.Gj. deklaroi se i ka dhënë në përdorim subjektit të rivlerësimit apartamentin në qytetin e Durrësit pa kundërshtim për një afat kohor të pacaktuar që ka filluar nga muaji prill 2014.

Kjo kontratë është lidhur pas kalimit të barrës së provës së subjektit të rivlerësimit.

Ndërkohë në seancën dëgjimore subjekti i rivlerësimit paraqiti deklaratë noteriale nr. ***, datë 07.01.2009, të znj. K.T., e cila deklaroi se:

“... përmbante edhe mundësinë e lënies në përdorim të një apartamenti, mikut personal të familjes time, z. Alfred Gjoni

...I kam lënë në përdorim e do vijoj ta bëjë këtë edhe në të ardhmen çdo aset në disponimin tim ligjor”.

Komisioni pasi analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionin e depozituar prej tij vlerëson se subjekti i rivlerësimit bazuar në:

- Paragrafin 1 dhe 5 të Aneksit D të Kushtetutës;
- Nenin 3/11, 30 - 33 si dhe shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016

është në kushtet e fshehjes së posedimit dhe përdorimit të një apartamenti në qytetin e Durrësit. Gjithashtu bazuar në rrethanat e mëposhtme:

- Mungesës të burimeve të ligjshme të z. H.Gj. për blerjen e këtij apartamenti.
- Posedimin dhe përdorimin e këtij apartamenti vetëm nga subjekti i rivlerësimit
- Deklarimet kontradiktore dhe të pasakta të subjektit të rivlerësimit gjatë hetimit administrativ.
- Fshehjes së posedimit dhe përdorimit të këtij apartamenti në deklaratën “Vetting”.

Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka në pronësi të fshehur apartamentin në qytetin e Durrësit.

4. Subjekti i rivlerësimit vetëm pas dërgimit të pyetësorit standard nga ana e Komisionit ka deklaruar se ka në përdorim tre makina, të cilat kishte detyrimi t’i deklaronte në deklaratën “Vetting” bazuar në Ankesin D pika 1 dhe 5 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 3/11, 30 - 33 si dhe shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016

Për sa më sipër rezulton se nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është deklaruar në deklaratën “Vetting” përdorimi i tre automjeteve.

Në lidhje me këtë konstatim subjektit të rivlerësimit i është kërkuar informacion shtesë. Në përgjigjen e tij ai sqaroi se: *Nuk ka pasur asnjëherë në përdorim të njëkohshëm, tre automjete.*

Përgjigja nënkuptonte për sa memorja lejon, tre raste gjithsej në të paktën 15 vite, prej kohës që ka marrë lejedrejtimi, ku ai ka huazuar për përdorim automjet.

Ky deklarami i subjektit nuk përputhet me parashikimet në kontratat e huapërdorjes nga ku rezulton se:

- Me kontratë huapërdorimi nr. ***, datë 18.08.2014, subjekti i rivlerësimit ka marrë në përdorim automjetin, tip “Audi Q 7” nga z. A.D.D. (kushëri i tij). Këtë automjet ai e ka marrë për një afat të pacaktuar me të drejtë për të qarkulluar brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu në kontratë përcaktohet se për gjatë kohës së marrjes në përdorim huamarrësi ka detyrimin ta ruaj dhe ta mbaj me përkujdesje për kohën që e ka marrë në dorëzim. Targa ***.
- Me kontratë huapërdorimi nr. ***, datë 01.10.2014 subjekti i rivlerësimit ka marrë në përdorim automjetin, tip “Mercedes Benz 204” (C 220 CDI), nga z. I.Sh. (vëllai i bashkëshortes). Këtë automjet ai e ka marrë për **një afat të pacaktuar** me të drejtë për të qarkulluar brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu në kontratë përcaktohet se për gjatë kohës së marrjes në përdorim huamarrësi ka detyrimin ta ruaj dhe ta mbaj me përkujdesje për kohën që e ka marrë në dorëzim. Targa ***.
- Me kontratë huapërdorimi nr. ***, datë 12.11.2015, subjekti i rivlerësimit ka marrë në përdorim automjetin, tip “Daimler Chrysler” nga z. E.Ç. (ish-shoferi i tij). Këtë automjet ai e ka marrë për **një afat të pacaktuar** me të drejtë për të qarkulluar brenda dhe jashtë Republikës së Shqipërisë. Gjithashtu në kontratë përcaktohet se për gjatë kohës së marrjes në përdorim huamarrësi ka detyrimin ta ruaj dhe ta mbaj me përkujdesje për kohën që e ka marrë në dorëzim. Targa ***.

Bazuar në parashikimet e kontratave më lartë rezulton se subjekti i rivlerësimit ka në përdorim të tre mjetet e mësipërme me afat të pacaktuar.

Më datë 04.09.2018 është ripyetur subjekti i rivlerësimit në lidhje me këtë gjetje. Nga ana e tij sqarohet se: *Asnjëherë nga ana e tij nuk ka pasur mbajtje të njëkohshme të dy apo më shumë mjeteve me qëllim përdorimi hua. Pavarësisht faktit që kontratat janë bërë për një afat të pacaktuar, sikurse rëndom ndodh në këtë lloj marrëdhënie kontraktore, qëllimi i marrjes hua ka qenë konkret dhe i dedikuar një udhëtim i vetëm jashtë shtetit. Që të mos bënte në çdo rast që i nevojitej kontratë e posaçme **me të afërm** nënshkruese në këto kontrata e pronarë të automjeteve, shtrirja kohore e të drejtës së përdorimit e cila nuk lidhet me shfrytëzimin e pandërprerë të automjetit, realizohet në kontratë në formën e papërcaktuar. Por ky fakt nuk do të thotë që ka mbajtur e përdorur në gjithë këtë periudhë këto automjete. Ai deklaroi se nuk i ka pasur kurrësi në pronësi apo përdorim vazhdues të pandërprerë këto mjete, veçmas apo aq më pak së bashku.*

Ky deklarami i subjektit nuk përputhet me përmbajtjen e kontratave si dhe për faktin se dhe pse kanë kaluar më shumë se 3-vjet ai nuk i ka zgjidhur ato.

Pasi i kaloi barra e provës subjekti i rivlerësimit dha shpjegimet e tij të cilat Komisioni gjykon se nuk janë bindëse pasi referuar:

Nenit 659 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë ku parashikohet se: *“Kontrata është veprimi juridik me anë të së cilës një ose disa palë krijojnë, ndryshojnë ose shuajnë një marrëdhënie juridike”*.

Nenit 660 të Kodit Civil ku parashikohet se: *“Palët në kontratë përcaktojnë lirisht përmbajtjen e saj, brenda kufijve të vendosura nga legjislacioni në fuqi”*.

Nenit 663 të Kodit Civil në të cilin përcaktohen kushtet e nevojshme për lidhjen dhe vlefshmërinë e kontratës, të cilat janë: *“Pëlqimi i palës që merr përsipër detyrimin; shkaku i ligjshëm në të cilin mbështetet detyrimi; objekti që formon lëndën e kontratës dhe forma e saj e kërkuar nga ligji”*.

Nenit 690 i Kodit Civil ku parashikohet se: *“Kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët. Ajo mund të priset ose të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të palëve ose për shkaqe të parashikuara me ligj”*.

Vlerësohet se nuk ekziston asnjë shkak ligjor që të vërë në dyshim vërtetësinë e fakteve të përshkruara në kontratat noteriale përfshirë këtu edhe afatin e përdorimit të mjeteve duke qenë se këto kontrata nuk janë revokuar ende nga palët duke ngarkuar me detyrim subjektin e rivlerësimit për deklarimin e tyre në deklaratën “Vetting”.

Në përfundim konstatohet se:

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” pjesën takuese të bashkëshortes së tij prej 9/288 të një apartamenti me sipërfaqe 83 m² ndodhur në Bulqizë.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka fshehur posedimin dhe përdorimin e një apartamenti në qytetin e Durrësit.
- iii. Subjekti i rivlerësimit ka në pronësi të fshehur një apartament në qytetin e Durrësit.
- iv. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të drejtën e përdorimit të tre automjeteve në deklaratën “Vetting”.

❖ Në lidhje me deklaratimet në pyetësonin standard dhe të dhënat e TIMS dhe AMF

1. Subjekti i rivlerësimit në pyetësonin standard ka deklaruar se, ai në periudhën **05.08.2013 - 12.08.2013** dhe bashkëshortja e tij për periudhën **27.07.2013 - 10.08.2013** kanë qenë në Bruksel te kushërinjtë e ish-shoferit të gjykatës z. Sh.Ç. ndërsa në pyetësonin e dytë në lidhje me këtë udhëtim ai ndryshon deklaratim duke thënë se kanë qenë në Prishtinë.

Në lidhje me këtë mospërputhje në deklaratimet e tij subjektit të rivlerësimit iu kërkua informacion shtesë. Ai sqaron se: *Për sa i përket udhëtimit, më datë 27.07.2018 - 10.08.2018, sipas sistemit TIMS ai rezulton së bashku me bashkëshorten me hyrje dalje në Morinë dhe sa i përket Brukselit ka qenë një lapsus nga ana e tij pasi ka qenë në një periudhë tjetër. Kjo dhe për shkak se dhe vetë TIMS ka probleme me paraqitjen e të dhënave. Për sa i përket kësaj periudhe me hyrje dalje nga Morina është qëndrim në Itali pranë vëllait dhe motrës sime dhe te vëllai e motra e bashkëshortes time. Për sa i përket udhëtimit në Bruksel kam qëndruar në Belgjik dhe Gjermani pranë shtetasit M.T. me banim në Fulda, të Gjermanisë.*

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit nuk përputhen me të dhënat në pasaportën e tij por dhe të sistemit TIMS më konkretisht nga verifikimi i pasaportës së subjektit të rivlerësimit me nr. *** rezulton se:

Në faqen *** ka **vulë hyrje**, më datë **06.08.2013**, në pikën kufitare hyrëse Karasoviçi, Kroaci.

Në faqen *** ka vulë hyrje, më datë 06.08.2013, në pikën kufitare hyrëse Krk, Kroaci.

Në faqen *** të ka vulë hyrje, më datë 06.08.2013, në pikën kufitare hyrëse Obrezje, Slloveni.

Në faqen *** ka **vulë dalje**, më datë **11.08.2013**, nga Aeroporti i Brukselit.

Nga sistemi TIMS rezulton se subjekti i rivlerësimit ka dalë, më datë **05.08.2013**, nga pika kufitare e Hanit të Hotit dhe ka hyrë, më datë **12.08.2013**, nëpërmjet Rinasit nga **Brukseli**, më datë 12.08.2013, ora 00:01.

Në sistemin TIMS edhe për bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit rezulton e njëjta datë kthimi, data **12.08.2013**, nëpërmjet Rinasit nga **Brukseli**, më datë 12.08.2013, ora 00:01.

2. Subjekti i rivlerësimit nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se ka përdorur mjetin me targa ***, më datë 20.05.2008, për të dalë nga pika kufitare e Morinës.

Nga shkresa e DPSHTRR-së, nr. *** prot., datë 02.10.2018, rezulton se ky mjet ka qenë në pronësi të z. L.N. i cili e ka blerë më datë 03.04.2006.

Është pyetur subjekti i rivlerësimit në lidhje me përdorimin e mjetit të z. L.N. si dhe nëse nga ana e tij ishte gjykuar ndonjë çështje me palë z. L.N. Më datë 19.10.2018, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se me z. L.N. **ka lidhje shoqërore** pasi ka qenë komshi me të dhe se nuk ka gjykuar asnjë çështje ku ky shtetas të ketë qenë palë. Ndërkohë, më datë 30.10.2018, subjekti i rivlerësimit ndryshon deklaratim në lidhje me z. L.N., duke deklaruar se: *“Në lidhje me çështjet me palë: z. L.N. ato datojnë në vitin 2007 dhe janë të një natyrë tërësisht konstatauese dhe roli i gjyqtarit është tërësisht i pandikueshëm nga çdo lloj interesi subjektiv të palës e për më tepër datojnë një vit para marrjes në përdorim të automjetit.”*

Bashkëlidhur përgjigjes subjekti i rivlerësimit ka vënë në dispozicion:

Vendim nr. ***, datë 19.04.2007, nëpërmjet së cilit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka vendosur pranimin e kërkesës së z. L.N. Konfirmimin e vdekjes së shtetasit A.P.N.

Vendim nr. ***, datë 28.05.2007, nëpërmjet së cilit Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin ka vendosur pranimin e kërkesës së z. L.N. Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësen M.N. duke përcaktuar si trashëgimtare ligjorë të tij fëmijët: Gj.N., D.Ç. (N.) e ëma e E.Ç., N.N., F.N., Gj.Gj. (N.), L.N., Y.N., A.N., K.N.

Nga vendimi i mësipërm konstatohet se në dispozitivin e tij rezulton se në rrethin e trashëgimtareve është përfshirë dhe z. A.N. i cili nga pjesa arsytuese -përshkuese e vendimit rezulton të ketë vdekur, më datë 03.04.1999, në Itali. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, nuk shprehet farë në lidhje me statusin civil të z. A.N. apo të faktit nëse ai ka pasur fëmijë.

3. Subjekti i rivlerësimit, më datë 9.10.2013, nga sistemi *TIMS* rezulton se ka përdorur automjetin me targa ***, në pronësi të z. I.D. i cili është avokat.

Ky fakt konfirmohet dhe nga shkresa e DPSHTRR-së nr. *** prot., datë 02.10.2018, nga ku rezulton se mjeti është blerë, më datë 24.01.2012, me kontratë nr. ***.

Është pyetur subjekti i rivlerësimit në lidhje me përdorimin e mjetit të z. I.D. si dhe nëse nga ana e tij ishte gjykuar ndonjë çështje ku z. I.D. të ketë qenë palë apo përfaqësues i palëve. Më datë 19.10.2018, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se: *Automjetin ia ka marrë avokat I.D. për një problem të tij në lidhje me shkollimin në Kosovë. Këtë person e ka takuar rastësisht dhe ja ka marrë mjetin në përdorim. Ai deklaroi se nuk i kujtohet të ketë pasur çështje pranë gjykatës së tij apo aq më shumë pranë tij si gjyqtar.*

Ndërkohë në përgjigjet e datës 30.10.2018, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se: *Çështja me palë z. I.D. (i referohet çështjes së mëposhtme) është e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Burrel, ku unë kam qenë anëtar i trupës gjyqësore i deleguar. Vendimmarrja ka qenë tërësisht objektive dhe e lënë në fuqi nga gjykatat më të larta. Për më tepër ai sqaroi se: Për kohën kur ai ka përdorur automjetin me targa ***, vetëm një ditë me shofer nuk ka pasur çështje penale me palë të përfaqësuar nga z. D. në cilësinë e avokatit e më tej në asnjë rast dhënia e automjetit për huapërdorje nuk do të përbënte arsye përjashtuese, për më tepër për vite më pas, nga gjykimi në çështje ku ky avokat është përfaqësues palësh. Me këtë avokat sikurse më këdo tjetër mund t'ju një seri vendimesh ku zgjidhja e nënshkruar prej meje të jetë e kundërt me interesat dhe pretendimet e palës që ai ka përfaqësuar.*

Në përfundim konstatohet se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklaram të rreme përpara Komisionit në lidhje me udhëtimin e tij në Bruksel.
- ii. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklarime të rreme përpara Komisionit në lidhje me gjykimin e çështjeve gjyqësore me palë z. L.N.
- iii. Subjekti i rivlerësimit në Vendim nr. ***, datë 28.05.2007, ka përfshirë në dispozitivin e vendimit në rrethin e trashëgimtarëve, z. A.N., i cili rezulton të ketë qenë i vdekur si dhe nuk është shprehur në lidhje me statusin civil të z. A.N. apo të faktit nëse ai ka pasur fëmijë.

- iv. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë deklarime të rremë në lidhje me z. I.D. pasi bazuar në deklaratimet e tij ai ka gjykuar çështje gjyqësore ku ky shtetas ka qenë përfaqësues i palëve.

B. NË LIDHJE ME VLERËSIMIN E AFTËSIVE PROFESIONALE

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar me nr. *** prot., datë 07.05.2018.

Nga ana e Komisionit është hartuar raporti i aftësive profesionale bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit.
- 2) Pesë dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së.
- 4) Ankesat e paraqitura pranë Komisionit.
- 5) Hetimi i kryer nga ana e Komisionit.

Bazuar në dokumentacionin e mësipërm rezultoi se:

- 1. Në lidhje me vendimi gjyqësor penal, nr. *****, datë 30.06.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin kundër të pandehurit N.Gj.

Çështja është regjistruar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kurbin, datën 21.10.2013, dhe vendimi është dhënë, më datën 30.06.2015. **Gjykimi ka zgjatur 1 vit, 8 muaj e 9 ditë, në tejkallim të afatit standard 1-vjeçar, të përcaktuar nga pika 5 shkronja “a” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit⁴.**

Trupi gjykues vlerëson se tejkallimi i afatit standard të gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

- 2. Në lidhje me vendimi gjyqësor civil, nr. *****, datë 21.01.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, që i përket paditësit: K.Gj., kundër të paditurve: T.P. e P.P.

⁴ Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. ***, datë 14.04.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”

Çështja është regjistruar për gjykim, më datën 10.03.2015, dhe vendimi është dhënë, më datën 21.01.2016. **Gjykimi ka zgjatur 9 muaj e 11 ditë, duke tejkuluar standardin kohor prej 6 muajsh të përcaktuar nga pika 5, shkronja “e” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.**

Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

3. Në lidhje me çështjen civile, nr. * regjistrimi, datë 11.02.2015 regjistrimi, që i përket paditësve: N.G. etj kundër të paditurit: OSHEE-së Tiranë.**

Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 1 vit 7 muaj e 23 ditë, në intervalin kohor 11.02.2015 – 03.10.2016 duke tejkuluar dukshëm afatin standard 6 mujor të përcaktuar nga pika 5 shkronja “e” të Aneksit 1 të Sistemit të Rivlerësimit.

Trupi gjykues vlerëson se tejkalimi i afatit standard të gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

4. Në lidhje me ankesën e shtetases Xh.J. paraqitur pranë KLD-së.

Kjo ankesë është verifikuar nga ana e IKLD-së dhe është konkluduar se nga ana e subjektit të rivlerësimit ka pasur zvarritje në gjykim, por shkaqet e shtyrjes së seancave kanë qenë ligjore dhe nuk mund të konsiderohet si shkelje në referim të detyrave gjyqësore të subjektit të rivlerësimit.

Komisioni pasi analizoi veprimet e subjektit të rivlerësimit gjykon se gjykimi është zvarritur për shkak të sjelljes së palëve dhe organizimit jo të mirë të punës nga ana e subjektit të rivlerësimit. Dy seanca janë shtyrë për t’ju vënë në dispozicion palëve vendimi i mospranimit të përjashtimit të subjektit të rivlerësimit. Dy seanca janë shtyrë për shkak se subjekti i rivlerësimit i kishte planifikuar në data të cilat ai kishte impenjime të tjera. Një seancë është shtyrë për shkak se prokuroria do t’i paraqiste gjykatës të gjitha aktet e administruara në fashikullin penal, të cilat nuk kishte asnjë arsye për të mos i dorëzuar që në seancën e parë. Një seancë është shtyrë për t’u njohur gjykata me fashikullin penal të cilin duhej ta kishte administruar që në seancat e para.

Trupi gjykues vlerëson se zvarritja e gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

5. Në lidhje me të dhënat nga Burime Arkivore të KLD-së

Nga ana e KLD-së në një verifikim të bërë, më datë 06.06.2016, mbi raportin e dërguar nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, mbi çështjet në gjykim mbi dy vjet është konstatuar se nga ana e subjektit të rivlerësimit është zvarritur pa arsye **për më shumë se dy vjet** çështja me palë paditëse: D.Sh. etj dhe Palë të paditur: ZVRPP-në Kurbin etj e cila ka qenë e regjistruar që më datë 23.12.2013. Në raportin e tyre inspektorët e ILKD-së deklarojnë se:

“Çmohet e pajustificuar mbajtja dy vjet e çështjes së pezulluar për të përfunduar lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë, proces që nuk ka arsye të zgjas më shumë se tre muaj.

Gjyqtari ka shfaqur neglizhencë në organizimin e punës dhe kjo është bërë shkak për zvarritjen e gjykimin.

Në përfundim kanë konkluduar se për sa kohë kemi të bëjmë më një çështje të vetme ajo t'i llogaritet për efekt vlerësimi profesional”.

Nga verifikimi në sistem rezulton se çështja është ende në gjykim dhe subjekti i rivlerësimit ka vijuar ta zvarris atë për të njëjtat arsye të paraqitura nga KLD-ja, pasi ai ka vendosur dhe dy herë të tjera pezullimin e saj më konkretisht, më datë 18.10.2016 dhe më datë 24.05.2017, për t'i dhënë mundësi z. P.N. për të çelur dëshminë e trashëgimisë për znj. D.N. ndërkohë, më datë 12.07.2018, është vendosur përjashtimi i tij.

Trupi gjykues vlerëson se zvarritja e gjykimin nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

6. Në lidhje me Ankesan e Shtetas Xh.J. pranë Komisionit.

Nga ana e Komisionit janë analizuar ankesat e kësaj shtetas ku për ankesën e datës 15.03.2018 nëpërmjet së cilës ankuesja ankohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka pranuar kërkesën e saj për përjashtimin e gjyqtarit D.M. si dhe mban qëndrim të njëanshëm duke dalë në mbrojtje të prokurorit është bërë verifikimi në sistemin e Gjykatës në lidhje me ecurinë e procesit. Nga verifikimi në sistem i kërkesës penale të ankueses rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer 14 seancë duke filluar nga data 06.04.2017 dhe përfunduar me dhënien e vendimit në datë 16.01.2018.

Gjykimi është zvarritur për shkak sjelljes së palëve dhe organizimit jo të mirë të punës nga ana e subjektit të rivlerësimit. Katër seanca janë shtyrë për t'i dhënë mundësi palës të mbrohet me avokat. Dy seanca janë shtyrë për t'i dhënë kohë avokatit të njihet me dosjen ndërkohë në vendim rezulton se ankuesja nuk është përfaqësuar me avokat. Dy seanca janë shtyrë për të paraqitur prokuroria kopje të fashikullit hetimor ndërkohë që prokuroria kishte detyrimin ligjor për të dorëzuar që në seancën e parë. Dy seanca janë shtyrë për mungesë të prokurorit. Një seanca është shtyre për t'i dhënë mundësi prokurorit për të paraqitur konkluzionet përfundimtare ndërkohë që dy seancat e mëparshme ishin shtyrë për arsye e mosparaqitjes së prokurorit dhe dhënies së kohës palëve për të përgatitur konkluzionet përfundimtare. Seanca e datës 08.01.2018 është shtyrë për shpallje vendimi.

Trupi gjykues vlerëson se zvarritja e gjykimit nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

7. **Në lidhje me vendimin gjyqësor penal nr. *****, datë 29.10.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, që i përket Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me objekt “Vleftësimin e ligjshëm të arrestimit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit ‘arrest në burg’, ndaj të dyshuarit Gj.V.

Nga analizimi i këtij vendimi rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka marrë në analizë dy kushtet thelbësore që parashikon neni 228/3 i K.Pr.Penale, për caktimin e masës së sigurimit “arrest në burg”, të cilat janë 1)rrezikshmëria e veçantë e veprës penale.2)rrezikshmëria e veçantë e autorit të dyshuar të veprës penale. Gjyqtari mjaftohet vetëm me parashtrimin e përcaktimeve të përgjithshme, abstrakte dhe jo konkrete.

Trupi gjykues vlerëson se mos analizimi si duhet i kushteve të nenit 228/3 të K.Pr. Penale nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

8. Në lidhje me ankesë e shtetasit P.V. paraqitur në KLD .

Kjo ankesë është verifikuar nga ILKD dhe është konkluduar se ka të bëjë me mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga gjykata dhe nuk ka vend për kryerjen e një verifikimi të karakterit disiplinor.

Bazuar në vendimin nr. *** datë 4.7.2007 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin ku subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar rezulton se Prokuroria ka kërkuar deklarinim fajtor të pandehurit për veprën penale “Të shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor” parashikuar nga neni 290/1 i K.Penal dhe “Drejtimit të mjetit në gjendje të dehur parashikuar” nga neni 291. Nga pjesa arsyetue-përshkruese e këtij vendimi rezulton se i pandehuri ka aksidentuar me pasojë vdekjen shtesën E.V. dhe ka dëmtuar shtetasin S.G. Pasoja e aksidentit ka qenë shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor nga ana e drejtuesit të mjetit dhe drejtimit të mjetit nën ndikimin e alkoolit. Gjykata në vendimin e saj arsyeton se në caktimin e masës së dënimit janë marrë parasysh këto rrethana:

Rrezikshmëria shoqërore e veprës penale dhe e të pandehurit.

Fakti që autori i saj nuk ka qenë i dënuar me parë dhe e ka pranua akuzën.

Gjendja e tij ekonomike.

Fakti që ndjehet i penduar për veprën penale.

Normalizimi i marrëdhënieve të pandehurit me familjen e viktimës.

Nga ana e Komisionit është analizuar dosja gjyqësore nga ku ka rezultuar se:

Në lidhje me normalizimin e marrëdhënieve të pandehurit me viktimën nuk rezulton që ato të jenë normalizuar për më tepër babai i viktimës është ankuar në KLD për këtë vendim duke e konsideruar si të padrejtë dënimin e të pandehurit me vetëm një vit burg.

Trupi gjykues vlerëson se konstatimi i mësipërm nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e subjektit, por ai mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

9. Nga ana e Komisionit është analizuar dhe vendimmarrja e subjektit të rivlerësimit në çështjen me nr. * regjistrimi, datë 12.05.2016, dhe vendimi nr. ***, datë 20.09.2016**

Nga shqyrtimi i vendimit nr. ***, datë 20.09.2016, rezulton se, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, ka ndryshuar kualifikimin ligjor të veprës penale për të pandehurin G.D., nga vrasje me paramendim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake, parashikuar nga nenet 78 e 278/2 të Kodit Penal, në veprën penale: Plagosje e rëndë me dashje me pasojë vdekjen, parashikuar nga neni 88/2 i Kodit Penal.

Në pjesën arsyetuese të Vendimit, konstatohet mungesa e argumentimit të konkluzionit që veprimet e të pandehurit plotësojnë elementët e veprës penale të “Plagosjes së rëndë me dashje” si dhe analizimi i këtyre elementëve të cilat në të gjitha vendimet e tjera të subjektit të rivlerësimit pasqyrohen qoftë dhe në formë të shkurtuar. Gjykata nuk shprehet se cila ka qenë arsyeja apo motivi që i pandehuri të plagoste viktimën (ana subjektive); ajo nuk trajton faktin se nga ana e të pandehurit, pa asnjë motiv të atypëratyshëm, është qëlluar në drejtim të viktimës me armë automatike. Bazuar në vendimin e gjykatës, rezulton se i pandehuri, pasi e ka thirrur viktimën dhe ai është kthyer, i ka qëlluar. Pra, gjykata, në ndryshimin e kualifikimit të veprës penale, duhej të argumentonte se, ç’motiv pati i pandehuri për të qëlluar në drejtim të viktimës, pa pasur një konflikt midis tyre të atypëratyshëm, që mund të çonte në konkluzionin e plagosjes së rëndë me dashje.

Në lidhje me këtë çështje në seancë gjyqësore nga ana e vëzhgues ndërkombëtar i është bërë pyetje subjektit të rivlerësimit se si do të vlerësonte veprën penale duke i dhënë rrethanat e faktit të mëposhtme (këto rrethana janë të njëjta me rrethanat e çështjes me të pandehur G.D.): *“Përdorimi i armëve luftarake, afërsia e autorit me objektivin, viktimën, përsëritja e qitjeve, drejtimi i qitjes drejt organeve jetësore të viktimës, fakti se në të njëjtën kohë aksidentalisht është vrarë nga autori një tjetër person i ndodhur afër vendit të ngjarjes, fakti që autori menjëherë përpara qitjes e thërret viktimën në emër”*

Nga ana e subjektit të rivlerësimit përgjigja ishte se ai mendonte që përderisa autori në i drejtohet në emër viktimës jemi para rastit të vrasjes me paramendim.

ANALIZA E GJETJEVE

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit përgjithësisht ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Zotëron legjislacionin bazë material dhe procedural mbi çështjet gjyqësore dhe kur është rasti, përdor edhe ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre. Ai e përdor jurisprudencën unifikuese në raste të rralla.

Nga analizimi i dosjeve evidentohet se subjekti i rivlerësimit ka njohuri të mira në fushën penale.

b) Arsjetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi nën mesatare në arsyetimin ligjor ndërsa në disa raste këto aftësi mungojnë si në rastin e vendimit nr. *** vendimi datë 20.09.2016, Vendimit nr. ***, datë 29.10.2016 vendimin nr. *** datë 4.7.2007 ku nga ana e tij argumentimi i vendimit nuk është i plotë si dhe i paqartë. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij, janë të thjeshta dhe në disa raste nuk janë të argumentuara si duhet. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit. Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar.

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kurbin për efekte të organizimit të shortit, konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016 subjekti i rivlerësimit, ka përfunduar së gjykuari 822 çështje, nga të cilat 448 çështje penale, 281 çështje civile të përgjithshme dhe 93 çështje familjare.

Nga analiza e të gjitha çështjeve, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Alfred Gjoni ka qenë në intervale kohore nga 1 ditë deri më shumë se 4 vjet. Nga ana e subjektit të rivlerësimit nga dosjet e analizuar rezulton se për shkak të organizimit jo të mirë nga ana e tij çështjet zvarriten tej standarteve minimale kohore.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit ka aftësi minimale për të kryer procedurat gjyqësore.

Në çështjet e vëzhguara, shumica e seancave gjyqësore kanë qenë jo produktive. Nga ana e tij nuk janë bërë përpjekje për shmangien e seancave jo produktive. Në disa raste seancat janë caktuar në ditë festash zyrtare apo në data ku subjekti i rivlerësimit ka pasur impenjime të tjera për të cilat ka qenë në dijeni më parë.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në çdo dosje të vëzhguar, subjekti i rivlerësimit ka nxjerrë vendim formal për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore. Në rastet kur seanca nuk është çelur pasi mungon gjyqtari, është mbajtur procesverbal administrativ nga sekretarja gjyqësore për të pasqyruar këtë fakt dhe për të njoftuar palët për seancën vijuese.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Alfred Gjoni pasi ai ka pasur mbi 19 ankesa nga të cilat disa kanë rezultuar që kanë pasur vende për verifikimi si dhe ka pasur shkelje nga ana e subjektit të rivlerësimit në lidhje me zvarritjen e procesit gjyqësor tej standartave minimale kohore pa arsye.

b) Integriteti

Nga të dhënat e administruar gjatë hetimit administrativ konstatohet se kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se subjekti i rivlerësimit komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Ai ka aftësi komunikuese me palët ndërgjyqëse gjatë veprimtarisë përgatitore e gjyqësore, ku shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar

barazinë e palëve. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar vetëm në një në seminar të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës (*shih* të dhënat tek Trajnimet në 3 Vitet e Fundit).

Nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është ndjekur formimi vazhdues sipas parashikimeve të nenit 5/2 germa “a” dhe nenit 76/4 -5 të ligjit nr. 96/2016 “Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Pasi i kaloi barra e provës subjekti i rivlerësimit paraqiti prova dhe shpjegime të cilat Komisioni vlerëson se nuk janë të mjaftueshme për të justifikuar zvarritjen e gjykimit tej afateve të gjykimit dhe mos argumentimit të duhur të çështjeve nga ana e tij pavarësisht fakti se ai ka qenë në rolin e anëtarit të trupës gjyqësore. Fakti se subjekti i rivlerësimit ka qenë anëtar i trupës gjyqësore në vendimet e konstatuara nga ana e Komisionit si jo të argumentuara si duhet nuk e përjashton atë nga përgjegjësia pasi ai në rolin e anëtarit kishte të drejtën e mendimit të pakicës.

Në përfundim të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit profesional, Komisioni çmon se të metat e konstatuara në shqyrtimin dosjeve gjyqësore të trajtuar më sipër reflektojnë mangësi profesionale të tilla, që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Të tilla mangësi konsiderohen, zvarritja e gjykimit tej afateve ligjore, mënyra jokorrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjor.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit e pasurisë dhe vlerësimin profesional si dhe vlerësimin tërësor të procedurave, Komisioni arrin në përfundimin se:

A. Për Vlerësimin e Pasurisë, Komisioni arrin në konkluzionin se:

- 1. Për apartamentin e banimit, me sipërfaqe 60 m², ndodhur në, Rr. “****”, subjekti i rivlerësimit:**
 - Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 1,154,846 lekë për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për pagesën e apartamentit.
 - Ka kryer deklaram të pasaktë dhe jo në përputhje me ligjin në lidhje me çmimin e blerjes së këtij apartamenti.
 - Ka mospërputhje deklarimesh gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me shpenzimet për mobilimin e këtij apartamenti.

- 2. Për apartament banimi, me sipërfaqe 47.74 m², ndodhur në, Rr. “****”, subjekti i rivlerësimit:**
 - Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e shtesës.
 - Ka kryer deklaram të rremë në deklaratën “Vetting” në lidhje me burimin e ligjshëm të ardhurave për blerjen e këtij apartamenti.
 - Ka kryer deklaram të rremë në deklaratën “Vetting” në lidhje me vitin e ndërtimit të këtij apartamenti.
 - I ka dhënë Komisionit përgjigje të ndryshme dhe kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit në lidhje me mobilimin e këtij apartamenti.

- 3. Në lidhje me likuiditet subjekti i rivlerësimit:**
 - Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për shlyerjen e kredisë së marrë në “Raiffeisen Bank”.
 - Nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” por dhe në asnjë nga deklaratat periodike të interesave private, hua e dhënë z. E.Ç. dhe nuk provon me dokumentacion provues kthimin e hua-së nga z. E.Ç.
 - Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar të ardhurat për dhënien e hua-së z. E.Ç.

- 4. Në lidhje me pasuritë e padeklaruara, ato në përdorim dhe të dhuruara subjekti i rivlerësimit:**
 - Nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” pjesën takuese të bashkëshortes së tij prej 9/288 të një apartamenti me sipërfaqe 83 m², ndodhur në Bulqizë.
 - Ka fshehur posedimin dhe përdorimin e një apartamenti në qytetin e Durrësit.
 - Ka në pronësi të fshehur një apartament në qytetin e Durrësit.
 - Nuk ka deklaruar të drejtën e përdorimit të tre automjeteve në deklaratën “Vetting”.

- 5. Në lidhje me deklaramet në pyetësorin standard dhe të dhënat e TIMS dhe AMF subjekti i rivlerësimit:**
 - Ka dhënë deklaram të rreme përpara Komisionit në lidhje me udhëtimin e tij në Bruksel.

- Ka dhënë deklarime të rreme përpara komisionit në lidhje me gjykimin e çështjeve gjyqësore me palë z. L.N.
- Në Vendim nr. ***, datë 28.05.2007, ka përfshirë në dispozitivin e vendimit në rrethin e trashëgimtarëve z. A.N. i cili rezulton të ketë qenë i vdekur si dhe nuk është shprehur në lidhje me statusin civil të z. A.N. apo të faktit nëse ai ka pasur fëmijë.
- Ka dhënë deklarime të rremë në lidhje me z. I.D. pasi bazuar në deklaratimet e tij ai ka gjykuar çështje gjyqësore ku ky shtetas ka qenë përfaqësues i palëve.

B. Për vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni arrin në konkluzionin se:

Komisioni çmon se të metat e konstatuara në shqyrtimin dosjeve gjyqësore të trajtuar më sipër reflektojnë mangësi profesionale të tilla, që nuk mund të plotësohen nëpërmjet programit të trajnimit. Të tilla mangësi konsiderohen, zvarritja e gjykimit tej afateve ligjore, mënyra jokorrekte e vlerësimit të fakteve dhe provave, argumentimi jo i plotë dhe jo në përputhje me dispozitat ligjor merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016

KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupa gjykuese e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, si dhe në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Alfred Gjoni, gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 14.01.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda Çiftja
Kryesuese

Firdes Shuli
Anëtare

Roland Ilia
Relator

Olsida Goxhaj
Sekretare gjyqësore